

# SHQIPËRIA N'KUVENDIM

18-21 NËNTOR 2021, TIRANË



Mbështetje për Parlamentin  
dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri

## SHËNIM

Ky dokument është realizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Pikëpamjet dhe përfundimet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Autorësia e këtij publikimi i përket Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim IDM. Ndalohet riprodhimi dhe shpërndarja e publikimit pa miratim paraprak me shkrim nga IDM.

## Adresa e IDM

Shenasi Dishnica Nr. 1, P.O Box 8177, Tirana, Albania

Tel: + 355 4 24 00 241 | Email: info@idmalbania.org

Website: www.idmalbania.org

DESIGN: EDUART CANI

## NJË PROJEKT



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC**

*"Mbështetja për Parlamentin dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri (PACEP)" është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim (SDC) dhe Bashkëpunim, zbatuar nga Prezenca e OSBE në Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan."*

## ZBATUAR NGA:



## PARTNERE NË ZBATIM:



*Ky aktivitet zhvillohet nga IDM në kuadër të projektit PACEP, në konsultim me Qendrën për Demokraci Deliberative pranë Universitetit të Stanford (ShBA).*

PARTNERËT MEDIATIKË :



# PËRMBAJTJA

<b>FJALA E MIRËSEARDHJES</b>	<b>5</b>
<b>HYRJE</b>	<b>6</b>
<b>PËRMBLEDHJE E PROPOZIMEVE</b>	<b>7</b>
MBIKËQYRJA PARLAMENTARE	7
ANGAZHIMI I QYTETARËVE	8
DEMOKRACIA E BRENDSHME E PARTIVE POLITIKE	10
REFORMA E SISTEMIT ZGJEDHOR	11
VOTA E DIASPORËS	13
IMIGRIMI EKONOMIK NË SHQIPËRI	15
NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE MJEDISI	17
<hr/>	
<b>ANALIZA E ÇËSHTJEVE</b>	<b>19</b>
MBIKËQYRJA PARLAMENTARE	20
ANGAZHIMI I QYTETARËVE	22
DEMOKRACIA E BRENDSHME E PARTIVE POLITIKE	24
SISTEMI ZGJEDHOR	26
VOTA E DIASPORËS	30
IMIGRIMI EKONOMIK NË SHQIPËRI	34



# FJALA E MIRËSEARDHJES

## *A nderuar pjesëmarrës*

Kemi kënaqësinë t'ju urojmë mirëseardhjen në këtë ushtrim të rëndësishëm praktik të demokracisë "Shqipëria n'Kuvendim". E vlerësojmë që jeni ju një nga 120 qytetarët shqiptarë të zgjedhur në mënyrë rastësore, që merr pjesë në ditët e aktivitetit më 18-21 nëntor, në Tiranë.

Gjatë këtyre katër ditëve, do të jeni së bashku me qytetarë të tjerë për të diskutuar mbi çështje të ndryshme politike dhe social-ekonomike, të tilla si mbikëqyrja parlamentare dhe pjesëmarrja e qytetarëve, demokracia e brendshme e partive politike, sistemi zgjedhor, mjedisi dhe imigrimi ekonomik, ku ekspertë të këtyre fushave do të jenë të pranishëm dhe do t'i u përgjigjen pyetjeve tuaja . Gjatë këtyre katër ditëve, do të diskutoni mbi pikëpamjet tuaja së bashku me qytetarë të tjerë që janë zgjedhur në mënyrë rastësore.

Për t'ju ndihmuar të përgatiteni për diskutimet në lidhje me këto çështje, kemi përgatitur këtë dokument përmbledhës me ndihmën e ekspertëve të fushave përkatëse. Ky dokument përmban informacione dhe argumente të ndryshme 'pro' dhe 'kundër' propozimeve të paraqitura për

secilën çështje. Në çdo pjesë të këtij dokumenti përmbledhës kemi bërë bashkë këndvështrime të ndryshme fakte objektive, duke përfituar nga përvoja e ekspertëve të fushës.

Ju ftojme të lexoni argumentet e ndryshme në tabelat përkatëse para diskutimeve në grup për çështjet në fjalë, argumente të cilave mund t'i referoheni edhe gjatë diskutimeve në grup. Për të përfituar sa më shumë nga pjesëmarrja juaj në këtë aktivitet, ju rekomandojmë të lexoni përmbledhjet e çështjeve para datës 18 nëntor, teksa shpresojmë se do ta lexoni të plotë dokumentin.

Ju falënderojmë që gjetët kohë për të marrë pjesë në këtë dialog kaq të veçantë.

[Mirëpresim të takohemi me ju.](#)

[Ju urojmë gjithë të mirat!](#)

[Ekipi i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim \(IDM\)](#)

## ÇFARË ËSHTË "ANKETIMI DELIBERATIV"?

Një model i zhvilluar fillimisht nga James Fishkin i Qendrës për Demokraci Deliberative pranë Universitetit Stanford, Anketimi Deliberativ ) është një përpjekje për të përdorur sondazhin e opinionit publik, në një formë të re dhe konstruktive. Fishkin dhe bashkëpunëtorët e tij Robert C. Luskin dhe Alice Siu kanë kryer Anketim Deliberativ në njëzet e katër vende të ndryshme të botës.

Anketimi Deliberativ është një formë e veçantë e konsultimit të politikave ku ndërthuren teknikat e hulumtimit të opinionit publik me debatet publike, për të nxjerrë në pah se çfarë mendon publiku për një çështje të caktuar, në rastet kur qytetarëve u jepet mundësia për t'u informuar më shumë.

Ky ushtrim i demokracisë deliberative në Shqipëri zhvillohet për herë të parë, nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në konsultim me Qendrën për Demokraci Deliberative, në kuadër të "Mbështetjeje për Parlamentin dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri" (PACEP), projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatuar nga NDI - Instituti Demokratik Amerikan.

# HYRJE

Angazhimi qytetar në demokraci dhe konsultimet publike kanë qenë çështje me rëndësi të cilat janë vënë shpeshherë në qendër të debatit publik përgjatë dekadës së fundit në Shqipëri. Në vitet 2012-2013 qytetarët dhe shoqëria civile kundërshtuan me sukses një nismë ligjore që do të bënte të mundur importin e mbetjeve. Të njëjtën gjë e bënë sërish në vitin 2015, kundër planeve për të çmontuar në Shqipëri armë kimike siriane. Gjatë periudhës 2016-2020 qytetarë të ndryshëm në Shqipëri, si studentë, minorë, naftëtarë, fermerë, komunitete vendore, etj. zhvilluan një sërë protestash jopolitike. Këto protesta të përsëritura qytetare flasin për potencialin e madh që ka angazhimi qytetar. Shpesh këto protesta qytetare janë nxitur apo shkaktuar nga mungesa e konsultimeve të mirëfillta publike. Kuvendi i Shqipërisë është vlerësuar me nota pozitive nga raporte të ndryshme të pavarura për përpjekjet e tij në përmirësimin e transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut, duke rritur aksesin për median ose shtimin e komunikimit me publikun e gjerë. Megjithatë, ende ka sfida si edhe mënyra për t'i adresuar ato.

Demokracia e brendshme e partive politike dhe nevoja për të përmirësuar sistemin zgjedhor me qëllim që të sigurohet integriteti i pjesëmarrjes politike dhe përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së partive politike, kanë qenë në vëmendje të debatit publik gjatë vitit 2020. Edhe pse në sistemin zgjedhor u bënë disa ndryshime, ka ende hapësirë për përmirësime dhe, në këtë kuptim, disa alternativa meritojnë vëmendjen e qytetarëve dhe vendimmarrësve. Ndonëse vendimmarrësit nuk janë ende të gatshëm të bëjnë përmirësime në kuadrin ligjor për një rritje të demokracisë së brendshme dhe llogaridhënies së partive politike presioni publik mund të nxisë rezultate edhe në këtë drejtim.

Ndërkohë që Shqipëria thëllon hendekun mes popullsisë rezidente (2.8 milionë) dhe diasporës (1.5 milionë), dhe vendi përballet me pasojat negative të emigrimit të rinjve dhe largimit të trurit, një çështje e re politike që u shfaq shumë fuqishëm në debatin publik gjatë vitit të kaluar ishte imigracioni (punësimi i të huajve në Shqipëri). Nga ana tjetër,

Kuvendi i Shqipërisë bëri ndryshime në Ligjin "Për të huajt" duke ia bërë më të lehtë bizneseve dhe sektorit privat në përgjithësi, të punësonin fuqi punëtore me kostot të lira nga vende më pak të zhvilluara.

Së fundi, ndryshimet klimatike dhe mjedisi kanë dominuar edicionet e lajmeve në mbarë globin. Edhe në Shqipëri këto tematika janë vënë shpesh në qendër të debateve dhe kanë nxitur ndërmarrjen e veprimeve, kryesisht nëpërmjet peticioneve dhe protestave qytetare.

Çështjet e mësipërme jo rrallë kanë shkaktuar ndarje të opinionit publik, teksa zgjidhjet për disa prej tyre nuk kanë arritur të japin prova dhe argumente të shëndosha. Për disa të tjera, vendimet ende nuk janë marrë (p.sh. demokracia e brendshme e partive politike, ndryshimet klimatike).

Ky aktivitet i jep mundësinë një kampioni të zgjedhur në mënyrë rastësore qytetarësh, që të bëhen bashkë për të diskutuar, për të përditësuar njohuritë dhe për të shprehur mendimet e tyre, duke u bazuar në informacion dhe fakte objektive për të dhënë mbështetjen për alternativa të ndryshme me anë të të cilave mund të trajtohen çështjet politike në fjalë.

Pjesëmarrja juaj në këtë aktivitet mund të ndikojë në jetën e qytetarëve shqiptarë dhe mund të përmirësojë edhe performancën e institucioneve publike.

# PËRMBLEDHJE E PROPOZIMEVE

## MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

Kontrolli dhe mbikëqyrja parlamentare janë funksioni ku Kuvendi i Shqipërisë tradicionalisht në këto 30 vjet ka performuar më dobët. Kushtetuta nuk garanton efikasitet të lartë të mekanizmave të kontrollit dhe balancës mes pushteteve. Kuvendi dhe qeveria dominohen nga një shumicë politike dhe lideri i partisë. Kriza politike e vitit 2019 dhe dalja e opozitës politike nga korniza institucionale vetëm sa nxorën në pah edhe më shumë dobësitë e pushtetit legjislativ (parlamenti). Falë parashikimeve kushtetuese dhe amendamenteve të vitit 2008, dallimi mes shumicës parlamentare dhe ekzekutivit është mjaft i vogël, duke e bërë të

vështirë respektimin e parimeve të kontrollit dhe balancës. Amendamentet kushtetuese të vitit 2008 kanë përforcuar veçanërisht edhe më shumë rolin e Kryeministrit dhe të liderit të partisë.

Për më tepër, sistemi zgjedhor dhe ligji për partitë politike i kanë dhënë shumë pushtet liderëve të partive, duke u bërë të atyre të mundur të kontrollojnë partinë dhe prej andej të ushtrojnë presion mbi të gjithë shtetin. Në raporte të ndryshme ndërkombëtare theksohet se mbikëqyrja parlamentare është aspekti më pak i zhvilluar i organit legjislativ kombëtar, pavarësisht rolit të tij vendimtar në sigurimin e një demokracie funksionale.

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<b>T'i mundësohet opozitës që të kryesojë të paktën 1/3 e komisioneve parlamentare.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Opozita politike mund të përmirësojë rolin mbikëqyrës të Kuvendit duke shqyrtuar dhe monitoruar me më shumë pavarësi punën e Qeverisë dhe institucioneve të tjera publike, gjë që mund të kontribuojë në zvogëlimin e abuzimeve me pushtetin dhe në nxitjen e përmirësimit të shërbimeve publike.</li> <li>■ Një tjetër efekt anësor i kësaj alternative është se ajo ndihmon në trajtimin e një tipari të njohur të politikës në Shqipëri – politikën konfliktuale. Duke e ditur se do të kenë një farë pushteti në Kuvend, kjo gjë i nxit partitë e opozitës të pranojnë rezultatet e zgjedhjeve, duke mos i parë këto të fundit si një lojë ku o fiton gjithçka ose nuk fiton asgjë. Rrjedhimisht, ndryshime të tilla mundën edhe të rrisin legjitimitetin e Parlamentit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Në një demokraci përfaqësuese, qytetarët zgjedhin me vullnetin e tyre të lirë të përfaqësohen në Kuvend nga partia ose kandidati që kanë zgjedhur. Përbërja e Kuvendit përfaqëson vullnetin e votuesve. Kështu, partitë, apo koalicionet, që marrin shumicën e vendeve në parlament, mandatohen nga qytetarët për të qeverisur vendin. Në këtë aspekt, po t'u japim më shumë pushtet partive politike që kanë marrë më pak vota, kjo do të bjerë ndesh me vullnetin e popullit.</li> <li>■ Opozita mund ta përdorë këtë pushtet për të minuar punën e qeverisë, ose për të bllokuar nismat e mazhorancës në Parlament, duke bërë që qeverisja të jetë joefikase.</li> </ul>

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<b>Krerët e institucioneve të pavarura (të cilët ndihmojnë kontrollin dhe llogaridhënien e ekzekutivit) të zgjidhen me shumicë të cilësuar (2/3) e votave në Parlament.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Propozimi do të rrisë pavarësinë e këtyre institucioneve.</li> <li>■ Kuvendi do të përballet me presion pozitiv nga raportet e institucioneve të pavarura për të vepruar sipas rekomandimeve të tyre</li> <li>■ Kontrolli dhe balanca e pushteteve do të përmirësohen përmes institucioneve të pavarura me performancë të lartë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Shumica e cilësuar nuk përbën garanci për pavarësi, pasi partitë e mazhorancës dhe opozitës mund të arrijnë marrëveshje që politizojnë institucionet e pavarura.</li> <li>■ Propozimi shton në mënyrë të panevojshme shanset për krizë politike, në rast se palët nuk arrijnë të zgjedhin titullarin e një institucioni të caktuar mbikëqyrës.</li> <li>■ Pavarësia e kryetarit të institucionit nuk përmirëson domosdoshmërisht mbikëqyrjen pa kompetenca dhe forma të qarta për mbikëqyrjen parlamentare.</li> </ul>
<b>T'i mundësohen opozitës më shumë burime njerëzore për të ushtruar kontrollin dhe mbikëqyrjen e qeverisë.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Rritet besimi i publikut në punën e Kuvendit dhe përmirësohet performanca e funksionit mbikëqyrës të parlamentit</li> <li>■ Mbështetet puna e institucioneve të tjera në rastin e komisioneve hetimore të Kuvendit (p.sh. gjykata, prokuroria)</li> <li>■ Përmirësohet cilësia e ligjeve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Rritja e numrit të stafit mbështetës nuk është e thënë se përmirëson domosdoshmërisht performancën e parlamentit pasi opozita mund ta keqpërdorë atë për kauzat e saj politike</li> <li>■ Diskriminohen partitë e tjera politike dhe deputetët e shumicës në pushtet, të cilët mund të jenë të prirur për të përmirësuar mbikëqyrjen parlamentare.</li> </ul>

## ANGAZHIMI I QYTETARËVE

Kushtetuta e Shqipërisë njihet zyrtarisht të drejtën e popullit për të ushtruar sovranitetin e tij me anë të referendumeve. Megjithatë, në tridhjetë vitet e fundit që nga rënia e komunizmit në Shqipëri janë mbajtur vetëm tre referendume, të gjitha organizuara me nismën e partive politike gjatë viteve '90, ku më i fundit u mbajt në vitin 1998 për miratimin e Kushtetutës së Shqipërisë. Neni 150 i Kushtetutës parashikon miratimin e një ligji për referendumet. Megjithatë, Kuvendi ende nuk ka miratuar ndonjë ligj sipas detyrimit kushtetues, përveç disa ndryshimeve në Kodin Zgjedhor (2003), të cilat shqyrtojnë rolin e Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve në organizimin e një referendumi.

Lulëzimi i teknologjisë dhe dixhitalizimi prezantuan forma dhe mjete më efikase të pjesëmarrjes qytetare, më i përhapuri prej të cilëve është peticioni online për çështje të ndryshme politike që kanë rëndësi për publikun. Ndonëse këto nisma shpesh marrin mbështetje të gjerë popullore, në pjesën më të madhe të rasteve, ato nuk merren parasysh nga Parlamenti dhe pothuajse asnjëherë nuk arrijnë të ndikojnë në programin politik të vendit. Për këtë qëllim, është me rëndësi parësore hartimi i një ligji që e kanalizon këtë energji në një formë efikase të pjesëmarrjes politike.



PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<p><b>T'u mundësohet zgjedhësve që të nënshkruajnë peticione online dhe të detyrojnë parlamentin të diskutojë për çështje të rëndësishme për publikun.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Përmirësohet mbikëqyrja parlamentare përmes rolit/ përfshirjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve.</li> <li>■ Bëhet mjet efikas që nxit përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe rrit besimin e publikut tek institucionet.</li> <li>■ Decentralizohet kontrolli mbi agjendën parlamentare dhe legjislative duke fuqizuar qytetarët.</li> <li>■ Nxiten parlamenti dhe partitë politike të trajtojnë shqetësimet/çështjet e qytetarëve për të cilat partitë politike kanë kundërshti ose hezitim.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Rrezikon të manipulohet nga partitë politike dhe/ose grupet private të interesit.</li> <li>■ Ndonëse Kuvendi mund të shqyrtojë çështjen për të cilën është nënshkruar një peticion online, ai nuk mund të vendosë domosdoshmërisht në favor të tyre.</li> <li>■ Manipulimi i këtij instrumenti nga partitë politike mund të thellojë hendekun dhe të rrisë nivelin e mosbesimit të publikut ndaj institucioneve.</li> </ul>
<p><b>Parashikimi i një buxheti (fonde publike) të veçantë për të mbuluar kostot e nisjes së një referendumit apo nismës ligjore qytetare.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Mbulimi i kostove të nismave qytetare i bën instrumentet e demokracisë së drejtpërdrejtë më të aksesueshme për votuesit.</li> <li>■ Fondi garanton se nisma të tilla nuk kushtëzohen plotësisht nga burimet financiare që kanë në dispozicion grupet e pasura të interesit, partitë politike apo edhe individë të pasur.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Fondet publike u hiqen shërbimeve të tjera publike, dhe ndoshta çështjeve më urgjente sociale dhe ekonomike</li> <li>■ Fondi dhe instrumentet mund të keqpërdoren nga grupet e interesit për të zhvilluar më tej me interesat e tyre.</li> </ul>
<p><b>Vendosja e detyrimit për të organizuar referendume për çështje të rëndësishme.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Forcohet demokracia e drejtpërdrejtë, angazhimi i qytetarëve dhe besimi i publikut tek institucionet.</li> <li>■ Merren vendime për çështje të rëndësishme që nuk ndikohen nga interesat konkurruese të grupeve politike apo të biznesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Shqipëria nuk ka një kulturë të mirëfilltë e të konsoliduar të demokracisë së drejtpërdrejtë si shoqëritë e tjera në Evropë (p.sh. Zvicra), prandaj interesi (pjesëmarrja e votuesve) mund të jetë i ulët.</li> <li>■ Rrit në mënyrë të panevojshme kostot publike për çështje që mund të trajtohen me procedura më pak të kushtueshme.</li> </ul>

## DEMOKRACIA E BRENDSHME E PARTIVE POLITIKE

Partitë politike shqiptare mbështeten jashtëzakonisht shumë në vendimmarrjen vertikale (nga lart poshtë) dhe jo në atë horizontale me anë të së cilës fuqizohen anëtarët. Ka dallim të madh edhe mes dispozitave ligjore në letër (Ligji “Për partitë politike”, statutet dhe rregulloret e partive, Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor) dhe zbatimit të tyre në praktikë. Në disa aspekte, pothuajse të gjitha partitë politike në Shqipëri veprojnë në kundërshtim me ligjin në raste të tilla si anashkalimi i zgjedhjeve periodike të brendshme, mosushtimi i demokracisë funksionale, lejimi i identifikimit të besimit fetar dhe

përkatësisë etnike, etj.

Shqipëria ka arritur të përvetësojë veçse një përvojë modeste në jetën e saj demokratike. Mungesa e një tradite të konsoliduar demokratike ka ushqyer tipare negative të demokracisë së brendshme të partive politike, së bashku me tendencën për të krijuar shumicë absolute, parti të forta dhe kryetarë të fortë me pushtet absolut, me privilegje dhe kompetenca të pakundërshtuara. Si pasojë, modeli dominues i partive në Shqipëri është ai i lidhur me kryetarin dhe një parti pa struktura funksionale sipas standardeve të demokracisë.

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<b>Të vendosen mekanizma konkurrimi brenda partive politike (p.sh., primaret e kandidatëve për zgjedhjet vendore dhe kombëtare).</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Përmirësohet besimi i publikut tek partitë politike (tradicionalisht më pak të besuara nga shqiptarët)</li> <li>■ Anëtarët e partive politike ndihen më të angazhuar dhe të fuqizuar</li> <li>■ Karriera politike brenda partisë lidhet më ngushtë me qytetarët dhe bazën e partisë, sesa me preferencat e liderit të partisë.</li> <li>■ Ulet përqendrimi i pushtetit në duart e liderit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Është një instrument i kushtueshëm që mund të zhvendosë fokusin e partive dhe anëtarëve drejt sigurimit të fondeve, dhe jo te meritokracia apo demokracia e brendshme.</li> <li>■ Primaret mund të shkaktojnë përçarje ose të thellojnë ato ekzistuese brenda partive përpara zgjedhjeve vendore/parlamentare.</li> <li>■ Mund të forcohen degët lokale të partive politike por jo domosdoshmërisht veprimet e tyre në nivel kombëtar</li> <li>■ Nuk nxjerr domosdoshmërisht në plan të parë rolin e strukturave të partisë</li> </ul>
<b>Të rritet financimi publik për partitë dhe kandidatët</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Fondet publike i bëjnë partitë politike dhe kandidatët e tyre më pak të varur nga financimet private (që shpesh vijnë me kushte për të përmbushur interesa private).</li> <li>■ Financimi publik i bën partitë politike më të përgjegjshme, pasi financat e tyre do të shqyrtohen, nëse është e nevojshme, edhe nga autoritete gjyqësore.</li> <li>■ Financimi publik bën që fokusi i partive politike të jetë i drejtuar tek problemet dhe politikat dhe jo në mbledhjen e fondeve për fushatë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Partitë politike mund të abuzojnë me fondet publike</li> <li>■ Nuk është e thënë që financimi publik t’i bëjë partitë më pak të varura nga ndikimi dhe interesat private.</li> <li>■ Fondet publike u hiqen shërbimeve të tjera publike, dhe ndoshta çështjeve më urgjente sociale dhe ekonomike.</li> </ul>

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<b>Të certifikohen financat e partive politike nga kompani ndërkombëtare.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Bën të mundur integritet më të lartë të financave të partive politike.</li> <li>■ Përmirësohet besimi i publikut tek partitë politike</li> <li>■ Mund të nxitet një kulturë donacionesh për partitë politike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Kostot janë shumë më të larta se të kompanive vendase dhe do të duhet të garantojen nga buxheti i shtetit.</li> <li>■ Kjo masë diskriminon bizneset vendase të auditimit.</li> </ul>

## REFORMA E SISTEMIT ZGJEDHOR

Sistemi zgjedhor është një nga shtyllat kryesore të sistemit politik të çdo vendi. Ai përkthen preferencat individuale politike të votuesve në një zgjedhje të vetme: një parlament i cili përfaqëson të gjithë vendin. Sistemi zgjedhor përcakton çështje thelbësore të tilla si: kriteri i përfaqësimit; përmasa e parlamentit; përmasa e zonave zgjedhore; sistemin e votimit; kush mund të zgjidhet dhe rregullat e tjera të konkurrimit politik. Për këtë qëllim, reformat zgjedhore duhet të hartohen dhe zbatohen me kujdes. Shqipëria ka bërë tetë reforma zgjedhore që nga rënia e komunizmit. Thuajse të gjitha reformat janë bërë me ngut, brenda një kohe të shkurtër, pa transparencë dhe pa përfshirjen e publikut.

Nga viti 2009, zgjedhjet janë zhvilluar me sistem proporcional. Votuesit votojnë partitë politike, ndërsa emrat e deputetëve vendosen nga partitë përmes listave të kandidatëve.

Sistemi i tanishëm shqiptar është një përzierje e veçantë mes listave të mbyllura dhe të hapura. Ky është tipari tjetër i sistemit tonë zgjedhor: Në këtë sistem listat partiake janë të renditura paraprakisht nga partitë politike, por votuesit kanë mundësi ta ndryshojnë këtë renditje me votën e tyre, por vetëm në rastet kur mbështetja e tyre është e madhe për ndonjë kandidat të renditur jashtë zonës fituese.

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<b>Kalimi nga sistemi aktual proporcional rajonal në sistemin proporcional kombëtar (me vetëm një listë kombëtare).</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Sistemi kombëtar e trajton çështjen e proporcionalitetit duke hequr "dënimin" që ky sistem u bën partive të tjera politike, përveç dy partive kryesore. Me një sistem të tillë kombëtar, numri mesatar i votave për deputet në Kuvend është pothuajse i barabartë mes të gjitha partive që sigurojnë vende në Kuvend. Për këtë arsye, ky sistem është më i ndershëm dhe më i paanshëm me të gjitha partitë politike.</li> <li>■ Ky sistem zhdok favorizimin që u bëhet aktualisht partive lokale në kurriz të partive të vogla kombëtare, duke dobësuar kështu tendencat klienteliste të nxitura nga sistemi aktual.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Sistemi kombëtar dobëson lidhjet e drejtpërdrejta mes votuesve dhe deputetëve/kandidatëve.</li> <li>■ Përqendrimi i vëmendjes së sistemit kombëtar dhe i deputetëve tek audiencia kombëtare e votuesve mund të krijojë distancë nga çështjet dhe shqetësimet që kanë komunitetet e ndryshme vendore.</li> <li>■ Në sistemin kombëtar, partitë politike fitojnë vlerë shtesë si përfaqësuese të elektoratit, në krahasim me deputetët si individë, duke forcuar kështu edhe rolin e partisë në dëm të rolit të deputetëve.</li> </ul>

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<p><b>Kalimi tek listat plotësisht të hapura në sistemin aktual zgjedhor.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Do të zbutet e ashtuquajtura presidentokraci partiake: dominimi i partive nga lideri i tyre, për shkak të fuqisë së tij de facto për të përcaktuar emrat dhe renditjen në listat e partisë.</li> <li>■ Do të rritet edhe konkurrenca dhe demokracia e brendshme e partive politike.</li> <li>■ Nga ana tjetër, do të forcohet edhe lidhja mes kandidatëve dhe votuesve, pasi fati i garës do të vendoset kryesisht nga votuesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Ky sistem mund të prodhojë diferenca tejet të mëdha në numrin e votave që merr një kandidat për të siguruar një vend ("super deputetë" që marrin shumë vota, siç janë drejtuesit kryesorë të partive).</li> <li>■ Do të krijohet një konkurrencë e fortë mes kandidatëve të partisë për të marrë sa më shumë vota, gjë që mund të krijojë një situatë jo të shëndetshme brenda partisë dhe të dëmtojë shanset e partisë për të fituar zgjedhjet.</li> </ul>
<p><b>Rikthimi në sistemin e mëparshëm zgjedhor me zgjedhjen e 100 deputetëve me sistem mazhoritar dhe 40 me sistem proporcional.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Ky sistem tenton të sjellë më të mirën e këtyre dy botëve: zgjedhjen e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve dhe lidhjen e drejtpërdrejtë mes votuesve dhe përfaqësuesve të tyre, duke siguruar kështu që partitë të përfaqësohen në Kuvend në raport me votën e tyre popullore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Problemi kryesor i këtij sistemi është se mundëson votimin strategjik: dy partitë e mëdha nuk kanë gjasa që të përfitojnë nga 40 mandatet proporcionale (duke qenë se numri i deputetëve që ato fitojnë në mazhorancë është zakonisht proporcionalisht më i madh se përqindja e votave proporcionale që këto parti marrin në zgjedhje). Partitë e mëdha krijojnë koalicione me parti më të vogla dhe u kërkojnë votuesve të tyre të votojnë për aleatët e tyre më të vegjël në votimin për partitë politike, për të bërë të mundur që vendet nga vota proporcionale të merren nga aleatët e tyre.</li> </ul>
<p><b>Kalimi në sistem të pastër mazhoritar (deputeti i çdo zone zgjidhet me shumicën e votave të qytetarëve).</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Kështu do të krijohet një lidhje e drejtpërdrejtë mes votuesve dhe përfaqësuesve të tyre</li> <li>■ Do të sigurohet një cilësi më e mirë e kandidatëve, pasi do të rritet konkurrenca mes kandidatëve në të gjithë vendin.</li> <li>■ Do të përmirësohet demokracia e brendshme e partive, pasi roli i udhëheqjes së partive në emërimin e kandidatëve do të jetë më i dobët: çdo kandidat mund të sfidojë vendimin e udhëheqjes së partisë për të emëruar një kandidat jopopullor, duke vendosur të kandidojë si i pavarur.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Argumenti kryesor kundër një sistemi të pastër mazhoritar është se ai deformon përfaqësimin e partive në Kuvend. Teorikisht, në rastin ekstrem, një parti e vetme politike mund të marrë të gjitha vendet në Kuvend me vetëm 51 për qind të votave popullore.</li> </ul>

## VOTA E DIASPORËS

Shqipëria është vendi me një nga diasporat më të mëdha në botë. Më shumë se një e treta e shtetasve të saj jetojnë në mënyrë të përhershme jashtë vendit. Sipas të dhënave të INSTAT, mbi 36% e rreth 4,4 milionë shtetasve shqiptarë jetojnë jashtë Shqipërisë: brenda jetojnë rreth 2,78 milionë shtetas, ndërsa jashtë jetojnë rreth 1,64 milionë shtetas.

Për shkak të shtetësisë, shqiptarët që jetojnë jashtë Shqipërisë kanë të drejtën të votojnë në zgjedhje. Kushtetuta i njehtë drejtën universale për të votuar të gjithë shtetasve të Shqipërisë, ndërsa Kodi Zgjedhor specifikon se të drejtën e ushtrojnë të gjithë shtetasit mbi 18 vjeç, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike

ose gjendjeje ekonomike për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Kodi Zgjedhor përcakton se për të ushtruar të drejtën e votës, shtetasit duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile; dhe të kenë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit.

Por pavarësisht se ata gëzojnë të drejtën e votës dhe mund të jenë të regjistruar në Regjistrin e Zgjedhësve, e vetmja mënyrë e tyre për ta ushtruar të drejtën e votës është të vijnë fizikisht për të votuar në Shqipëri. Shqiptarët që jetojnë jashtë Shqipërisë mund të ushtrojnë të drejtën e votës vetëm nëse janë të regjistruar në një qendër votimi në Shqipëri dhe vetëm duke ardhur në Shqipëri për të votuar.

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<p><b>Qytetarëve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit duhet t'u mundësohet votimi për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri pranë misioneve tona diplomatike në shtetet e huaja.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Forcohen lidhjet e komunitetit të jashtëm me komunitetin politik kombëtar.</li> <li>■ Qytetarëve që jetojnë jashtë vendit u ofrohet mundësia e promovimit të agjendës së tyre legislative.</li> <li>■ Qytetarët që jetojnë jashtë vendit mund të përfshihen drejtpërdrejt në debatet dhe proceset vendimmarrëse politike, për çështje me interes kombëtar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ U jepet pushtet vendimtar atyre që nuk jetojnë në Shqipëri dhe nuk ndërveprojnë drejtpërdrejt me qeverisjen dhe me pasojat e politikës, për të përcaktuar qeverisjen dhe politikën e vendit. Si përfundim: rezultati i zgjedhjeve dhe pushteti që do të vendoset në Shqipëri do të përcaktohet nga njerëz që nuk jetojnë në Shqipëri.</li> <li>■ Për emigrantët në vende si Kanada, SHBA, por edhe në Gjermani dhe Francë kjo mund të jetë e vështirë. Në këto vende, Shqipëria ka një ambasadë në kryeqytet dhe, në rastin më të mirë, një ose dy konsullata në qytete të tjera. Prandaj, emigrantët që nuk banojnë pranë këtyre qyteteve do t'u duhet të udhëtojnë distanca të gjata për të votuar.</li> <li>■ Shqetësimi për besueshmërinë politike. Në të shkuarën qeveritë janë akuzuar se kontrollojnë administratën publike dhe votimi në selitë diplomatike mund të krijojë mosbesim tek partitë politike në opozitë në lidhje me ndershmërinë e procesit të votimit dhe numërimit të votave.</li> </ul>

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<p><b>Qytetarëve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit duhet t'u mundësohet votimi për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri me postë të zakonshme.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Çdo person që kërkon të votojë me anë të postës, i dërgohet një fletëvotimi me postë speciale/rekomande, me kostot e postës që mbulohen nga buxheti i shtetit . Kjo u mundëson të gjithë shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë vendit të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës, pavarësisht pranisë së misionit diplomatik në vendin pritës apo jo.</li> <li>■ Forcohen lidhjet e komunitetit të jashtëm me komunitetin politik kombëtar.</li> <li>■ Qytetarëve që jetojnë jashtë vendit u jepet mundësia e promovimit të agjendës së tyre legjislative</li> <li>■ Qytetarët që jetojnë jashtë mund të angazhohen drejtpërsëdrejti në debatet dhe proceset vendimmarrëse politike që janë me interes kombëtar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Votimi me postë mund të kushtojë deri në 30 milionë euro, nëse do të votonin deri në 1 milionë shtetas jashtë vendit, duke pasur parasysh se posta rekomande nga Evropa dhe SHBA-të kushton rreth 20-30 euro për dy dërgesa (çuarja dhe marrja e fletëvotimit) . .</li> <li>■ U jepet pushtet vendimtar atyre që nuk jetojnë në Shqipëri dhe nuk ndërveprojnë drejtpërdrejt me qeverisjen dhe me pasojat e politikës, për të përcaktuar qeverisjen dhe politikën e vendit. Si përfundim: rezultati i zgjedhjeve dhe pushteti që do të vendoset në Shqipëri do të përcaktohet nga njerëz që nuk jetojnë në Shqipëri.</li> </ul>
<p><b>Qytetarëve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit duhet t'u mundësohet votimi elektronik për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Procesi i votimit administrohet lehtësisht dhe nuk kërkon burime njerëzore për administrimin e procesit</li> <li>■ Forcohen lidhjet e komunitetit të jashtëm me komunitetin politik kombëtar.</li> <li>■ Qytetarëve që jetojnë jashtë vendit u jepet mundësia e promovimit të agjendës së tyre legjislative</li> <li>■ Qytetarët që jetojnë jashtë mund të angazhohen drejtpërsëdrejti në debatet dhe proceset vendimmarrëse politike për çështje me interes kombëtar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Ka kosto që lidhen me këtë opsion (p.sh. teknologjia, pajisjet), por ka edhe një sfidë që lidhet me besimin në votën elektronike, sfidë që duhet të kapërcehet.</li> <li>■ U jepet pushtet vendimtar atyre që nuk jetojnë në Shqipëri dhe nuk ndërveprojnë drejtpërdrejt me qeverisjen dhe me pasojat e politikës për të përcaktuar qeverisjen dhe politikën e vendit. Si përfundim: rezultati i zgjedhjeve dhe pushteti që do të vendoset në Shqipëri do të përcaktohet nga njerëz që nuk jetojnë në Shqipëri.</li> </ul>

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
Shqipëria duhet të sigurojë vende të dedikuara në parlament për të cilat diaspora shqiptare (qytetarët shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit) të votojë dhe të zgjidhet.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Forcohen lidhjet e komunitetit të jashtëm me komunitetin politik kombëtar.</li> <li>Qytetarëve që jetojnë jashtë vendit u jepet mundësia e promovimit të agjendës së tyre legislative</li> <li>Qytetarët që jetojnë jashtë mund të angazhohen drejtpërsëdrejti në debatet dhe proceset vendimmarrëse politike për çështje me interes kombëtar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Argumenti kryesor kundër këtij propozimi është se ndonëse do të sigurohen vota nga jashtë vendit, pesha e një votimi të tillë do të jetë më e dobët, duke qenë se nuk do të ketë asnjë efekt praktik në përcaktimin e fituesit të zgjedhjeve dhe si rrjedhojë edhe të politikave qeveritare.</li> </ul>

## IMIGRIMI EKONOMIK NË SHQIPËRI

Gjatë tre dekadave të fundit, më shumë se 1.62 milionë shtetas shqiptarë, ose gati 40% e totalit, jetojnë sot në mënyrë të përhershme në vende të tjera. Qindra mijëra të tjerë emigruan jashtë vendit dhe më pas u rikthyen në Shqipëri—një pjesë për të ri-emigruar sërish. Emigrimi i shqiptarëve pritet të vazhdojë me ritme të larta në vitet e ardhshme, kryesisht përmes rrugëve të ligjshme. Bashkimi familjar dhe emigrimi në kuadrin e programeve të imigrimit të vendeve perëndimore janë dy mënyrat kryesore të emigrimit që largojnë nga vendi mijëra shqiptarë çdo vit.

Së fundmi, emigrimi i personave me kualifikim të lartë është rritur eksponencialisht gjatë dekadës së fundit, ku çdo vit mijëra profesionistë aplikojnë për të emigruar. Si rezultat, në shumë sektorë të vendit kërkesa për punësim është më e lartë se oferta. Në këtë sfond emigrimi, shqiptarët po ndeshen me një aspekt tjetër të migrimit: imigrimin, ardhjen në Shqipëri të shtetasve të huaj. Edhe pse një popull në përgjithësi emigrant dhe me përfitime të mëdha, imigrimi i të huajve në Shqipëri, veçanërisht nga vende të caktuara të botës, ka ngjallur ndjesi dhe qëndrime të paprovuara më parë dhe shpesh të debatueshme.

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
Shqipëria duhet të jetë e hapur të pranojë fuqi të huaj punëtore (imigrantë).	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në shumë sektorë nuk ka shqiptarë të gatshëm për t'u punësuar dhe rrjedhimisht imigrantët do të punësohen në vendet e mbetura bosh. Për shumë kompani, sidomos në ndërtim dhe fasoneri, kjo gjë do të jetë shpëtim nga falimentimi, pasi këto kompani ndeshen me rritje të kostove dhe me mungesë kapacitetesh prodhuese si rrjedhojë e mungesës së fuqisë punëtore. Një falimentim i tillë do të shtonte më tej papunësinë mes shqiptarëve, pasi të gjithë punonjësit e kompanive, përfshirë këtu edhe ata në pozicione të mira ku kërkohen aftësi të larta, do të humbisnin vendin e punës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ardhja e të huajve do të rrisë papunësinë mes popullsisë shqiptare. Shqipëria ka një përqindje të lartë papunësie. Ardhja e të huajve do të rrisë papunësinë mes popullsisë shqiptare. Imigrantët do të shtojnë papunësinë, pasi çdo vend pune i zënë prej tyre është një vend pune që i merret një punëtori vendas. Në këtë mënyrë, imigrimi i të huajve do të nxisë edhe më shumë emigrimin e shqiptarëve.</li> </ul>

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Punëtorët e pakualifikuar që kanë humbur vendin e punës për shkak të imigrantëve, do të kenë tanimë motivimin që të arsimohen e të ndjekin trajnime për të rritur nivelin e aftësive, dhe për të konkurruar për vende pune ku rroga është më e lartë dhe konkurrenca nga punëtorët e huaj është jo-ekzistente. Kështu, punëtorët e pakualifikuar vendas do të kenë më shumë mundësi për të investuar në përfitim të zanateve dhe profesioneve që kërkojnë kualifikime më të mira.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Ardhja e imigrantëve të pakualifikuar do të ulë rrogat e punëtorëve vendas të pakualifikuar dhe punëdhënësit, duke pasur kërkesë më të ulët për rroga nga imigrantët, do të refuzojnë punësimin e punonjësve të pakualifikuar vendas që duan rroga pak më të larta.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Në vendet e zhvilluara punëtorët e pakualifikuar luajnë një rol të madh ekonomik. Ata çlirojnë fuqinë punëtore vendase nga puna me produktivitet të ulët për t'u fokusuar në punën me produktivitet të lartë. Rasti tipik është ai i vendeve perëndimore të BE-së. Ardhja e fuqisë punëtore të pakualifikuar nga vendet lindore që iu bashkuan BE-së pas rënies së komunizmit bëri të mundur që punëtorët vendas, si britanikët, francezët, danezët, gjermanët, etj., të specializoheshin në punë më të kualifikuara, duke ua lënë punët që kërkonin krahë të lirë pune imigrantëve. Kjo rriti produktivitetin ekonomik të vendit me një ritëm më të shpejtë.</li> <li>■ Imigrantët e huaj që vijnë nga kultura dhe shoqëri të ndryshme do të pasurojnë kulturën dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi, përmes sjelljes së ideve të reja.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Krahu i lirë i punës do të ulë dhe mbajë të ulur produktivitetin e ekonomisë së vendit, duke mbajtur të pazhvilluar industrinë dhe duke mos bërë të mundur përmirësimin e strukturës ekonomike. Që një vend të zhvillohet, duhet të rrisë produktivitetin dhe të prodhojë më shumë me të njëjtën fuqi punëtore dhe lëndë të parë. Në vend që të rrisin investimet në teknologji të avancuara dhe aktivitete më komplekse, për t'i mbijetuar konkurrencës dhe për të ruajtur fitimet, bizneset mbeten në sektorë ku puna manuale është një faktor i rëndësishëm, pasi kostoja e punës mbetet e ulët.</li> </ul>



PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
		<ul style="list-style-type: none"> <li data-bbox="1057 243 1468 897">■ Nxitet largimi i fuqisë punëtore të kualifikuar. Ruajtja e ekonomisë së pazhvilluar me fuqi punëtore të lirë nxit më tej emigrimin e punëtorëve të kualifikuar. Nëse nuk zhvillojmë teknologjinë e informacionit dhe komunikimit si dhe sektorë me vlerë të shtuar, profesionistët do të largohen. Në fakt, emigracioni shqiptar kohët e fundit është më i përhapur mes profesionistëve (mjekë, inxhinierë, ekspertë IT etj.). Ekonomia shqiptare nuk u ofron atyre mundësi konkurruese dhe shpërblime.</li> <li data-bbox="1057 927 1468 1198">■ Imigrimi i të huajve nga vendet e pazhvilluara dëmton harmoninë sociale. Ka një shqetësim të madh se ardhja e të huajve nga kultura dhe shoqëri të ndryshme do të krijojë probleme sociale në vend.</li> </ul>

## NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE MJEDISI

Mjedisi ka qenë një pjesë e vazhdueshme e debatit politik në dy dekadat e fundit, veçanërisht për sa i përket shërbimeve mjedisore, si çështjet që lidhen me menaxhimin e integruar të mbetjeve, trajtimin e ujërave të zeza, etj. Në vitet e fundit, debati është zhvendosur edhe në çështje të tjera, si ndryshimet klimatike, sektori i transportit të qëndrueshëm, prerjet e paligjshme, gjuetia, mirëqenia e kafshëve etj. Edhe pse Shqipëria nuk ka të miratuar një strategji për mjedisin, ajo ka miratuar së fundmi (korrik 2019) Dokumentin Strategjik së bashku me Planin Kombëtar për Zbutjen e Gazraveme Efekt

Serrë (NMP) dhe Planin Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP). Kuvendi i Shqipërisë nënshkroi Marrëveshjen e Parisit më 14 korrik 2016, duke hyrë në fazën e re të politikave ndërkombëtare të klimës. Në këto politika është përfshirë sektori i transportit, që është edhe konsumatori më i madh i energjisë (39.15% në vitin 2014). Numri i automjeteve në rrugë po rritet vazhdimisht, ndërkohë që transporti publik ka humbur më shumë se 50% të pasagjerëve gjatë dy dekadave të fundit. Rritja e ndjeshme e numrit të mjeteve rrugore u shoqërua me rritje të aktivitetit të transportit dhe rritje të dukshme të konsumit të karburanteve, kryesisht naftë dhe benzinë.

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
Shqipëria duhet të bëjë të detyrueshëm emetimin zero të karbonit për makinat, kamionët, autobusët deri në 2035.	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Në këtë mënyrë do të ndihmohjë Shqipërinë të shkojë drejt transformimit të nevojshëm energjetik, për të shmangur katastrofën klimatike,</li> <li>■ Dekarbonizimi i sektorit të transportit është një nga çështjet kryesore që duhet trajtuar me qëllim që të arrihet përmbushja e objektivave të vendosur.</li> <li>■ Ky transformim do të reduktojë ndotësit e ajrit (NOx, SOx. etj.)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Ndryshimi në një afat relativisht të shkurtër kohor do të sjellë kosto shumë të larta financiare dhe kosto të tjera që ekonomia nuk mund t'i përballojë.</li> <li>■ Nuk është ngritur ende infrastruktura për karikimin e automjeteve elektrike.</li> <li>■ Shqipëria nuk është një eksportues neto i energjisë elektrike dhe si e tillë rritja e kërkesës do të kërkojë më shumë import të energjisë elektrike.</li> </ul>
Shqipëria duhet të ndalojë importin e makinave të përdorura më shumë se 5 vjet.	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Me këtë hap do të zvogëlohen emetimet (shkarkimet) për numër makinash dhe do të përmirësohet cilësia e ajrit, veçanërisht në qytetet e mëdha.</li> <li>■ Makinat e reja do të sjellin përmirësimin e efikasitetit të karburantit dhe rrjedhimisht më pak konsum të karburantit</li> <li>■ Kjo është në përputhje me politikat e BE-së në sektorin e transportit (standartet Euro)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Me nivelin e të ardhurave që kanë aktualisht, qytetarët e thjeshtë nuk mund t'i përballojnë dot kostot e blerjes së një automjeti të ri.</li> <li>■ Në vend ka një sektor mjaft të madh të shitësve të makinave të përdorura dhe pjesëve të këmbimit të përdorura, që do të vuajnë në këtë tranzicion.</li> <li>■ Për momentin nuk ka stimuj të drejtpërdrejtë nga të cilët klientët përfitojnë, në rast se duan të kalojnë në përdorimin e makinave të reja</li> </ul>
Jam dakord që në qytetet e mëdha të krijohen zona me emetim të ulët (p.sh. në qendër të qytetit të lejohet qarkullimi vetëm i mjeteve elektrike)	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Qendrat e mëdha urbane vuajnë nga ndotja dhe bllokimi i trafikut që vjen si rezultat i trafikut të makinave</li> <li>■ Zonat me emetim të ulët do të nxisin përdorimin e alternativave miqësore me mjedisin (transport publik, biçikleta etj.)</li> <li>■ Përmirësohet cilësia e jetës së njerëzve që jetojnë në qendër të qyteteve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Njerëzit do të kundërshtojnë pagesën e një takse tjetër që lidhet me qarkullimin</li> <li>■ Reduktimi i trafikut në qendër do ta kalojë problemin në pjesë të tjera të qytetit.</li> <li>■ Transporti publik dhe alternativat e tjera nuk janë ende në nivelin e dëshiruar të cilësisë për të justifikuar këtë propozim.</li> </ul>

# ANALIZA E ÇËSHTJEVE

## MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

### KONTEKSTI

Në shkurt të vitit 2019 partitë e opozitës në Shqipëri hoqën dorë nga mandati i deputetit me pretendimin se opozita nuk kishte asnjë rol në parlament, dhe për këtë arsye ajo nuk do të vepronte më si fasadë për një regjim që kontrollonte gjithçka. Një lëvizje e tillë e opozitës rezultoi katastrofike jo vetëm për vetë partitë e opozitës, por, mbi të gjitha, edhe për vetë situatën e demokracisë dhe cilësisë së qeverisjes në vend. Pas një vlerësimi relativisht të qëndrueshëm të demokracisë mes viteve 2015 dhe 2018, raporti i Freedom House "Kombet në Tranzicion" (Nations in Transit) e uli vlerësimin e demokracisë së Shqipërisë për dy vjet radhazi, duke filluar që nga viti 2019.<sup>1</sup> Parlamenti jo vetëm që nuk arriti të ushtronte asnjë mbikëqyrje mbi Ekzekutivin, por përkundrazi ai u kthye në noter për vendimet e qeverisë.

Në fakt, kontrolli dhe mbikëqyrja parlamentare janë funksioni më i dobët i Kuvendit të Shqipërisë. Kushtetuta nuk garanton efikasitet të lartë të mekanizmave të kontrollit dhe balancës. Kuvendi dhe qeveria dominohen nga një shumicë politike dhe lideri i partisë. Kriza politike e vitit 2019 dhe dalja e opozitës politike nga korniza institucionale vetëm sa nënvizuan punën aktualisht mjaft të dobët të degës legjislative të pushtetit në këtë drejtim. Falë parashikimeve kushtetuese dhe amendamenteve të vitit 2008, dallimi mes shumicës parlamentare dhe ekzekutivit është mjaft i vogël, duke e bërë të vështirë respektimin e parimeve të kontrollit

dhe balancës. Amendamentet kushtetuese të vitit 2008 kanë përforcuar veçanërisht edhe më shumë rolin e Kryeministrit dhe të liderit të partisë. Këto ndryshime në kushtetutë u justifikuan si një formë promovimi e stabilitetit politik, për të kapërcyer kriza të panevojshme politike, por një gjë e tillë nuk mund të ishte më larg nga e vërteta.

Po ashtu, disa institucione të pavarura si Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), Avokati i Popullit e të tjerë, të cilët kanë për detyrë t'ë bëjnë që institucionet shtetërore dhe proceset e drejtuara nga qeveria të japin llogari dhe rrjedhimisht të ndihmojnë në kontrollin dhe balancimin e pushteteve, kanë dështuar në këtë drejtim për arsye të ndryshme.<sup>2</sup>

Për më tepër, sistemi zgjedhor dhe ligji për partitë politike i kanë dhënë shumë pushtet liderëve të partive, duke u bërë të atyre të mundur të kontrollojnë partinë dhe prej andej të ushtrojnë presion mbi të gjithë shtetin. Në raporte të ndryshme ndërkombëtare theksohet se mbikëqyrja parlamentare është aspekti më pak i zhvilluar i organit legjislativ kombëtar, pavarësisht rolit të tij vendimtar në sigurimin e një demokracie funksionale.

Prandaj, forcimi i funksioneve mbikëqyrëse të Kuvendit dhe i performancës së tij është prioritet i rëndësishëm, me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e qeverisjes dhe demokracisë në Shqipëri.

....

- 1 Shih raportet e Freedom House 'Nations in Transit' për Shqipërinë, gjenden në <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-in-transit>
- 2 Për disa institucione (p.sh. Komisioneri për të Drejtën e Informimit) kjo ndodh për llogari të mungesës së pavarësisë së vërtetë, duke pasur parasysh faktin se drejtuesit e tyre zgjidhen me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi. Për disa të tjerë (p.sh. Avokati i Popullit) ndodh sepse kompetencat e tyre janë të kufizuara vetëm në rekomandime dhe përgatitje të raporteve me gjetje

PROPOZIMI DHE ARGUMENTET PRO DHE KUNDËR

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<p><b>T'i mundësohet opozitës që të kryesojë të paktën 1/3 e komisioneve parlamentare.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Opozita politike mund të përmirësojë rolin mbikëqyrës të Kuvendit duke shqyrtuar dhe monitoruar me më shumë pavarësi punën e Qeverisë dhe institucioneve të tjera publike, gjë që mund të kontribuojë në zvogëlimin e abuzimeve me pushtetin dhe në nxitjen e përmirësimit të shërbimeve publike.</li> <li>■ Një tjetër efekt anësor i kësaj alternative është se ajo ndihmon në trajtimin e një tipari të njohur të politikës në Shqipëri – politikën konfliktuale. Duke e ditur se do të kenë një farë pushteti në Kuvend, kjo gjë i nxit partitë e opozitës të pranojnë rezultatet e zgjedhjeve, duke mos i parë këto të fundit si një lojë ku o fiton gjithçka ose nuk fiton asgjë. Rrjedhimisht, ndryshime të tilla mundën edhe të rrisin legjitimitetin e Parlamentit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Në një demokraci përfaqësuese, qytetarët zgjedhin me vullnetin e tyre të lirë të përfaqësohen në Kuvend nga partia ose kandidati që kanë zgjedhur. Përbërja e Kuvendit përfaqëson vullnetin e votuesve. Kështu, partitë, apo koalicionet, që marrin shumicën e vendeve në parlament, mandatohen nga qytetarët për të qeverisur vendin. Në këtë aspekt, po t'u japim më shumë pushtet partive politike që kanë marrë më pak vota, kjo do të bjerë ndesh me vullnetin e popullit.</li> <li>■ Opozita mund ta përdorë këtë pushtet për të minuar punën e qeverisë, ose për të bllokuar nismat e mazhorancës në Parlament, duke bërë që qeverisja të jetë joefikase.</li> </ul>
<p><b>Krerët e institucioneve të pavarura (të cilët ndihmojnë kontrollin dhe llogaridhënien e ekzekutivit) të zgjidhen me shumicë të cilësuar (2/3) e votave në Parlament.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Propozimi do të rrisë pavarësinë e këtyre institucioneve.</li> <li>■ Kuvendi do të përballët me presion pozitiv nga raportet e institucioneve të pavarura për të vepruar sipas rekomandimeve të tyre</li> <li>■ Kontrolli dhe balanca e pushteteve do të përmirësohen përmes institucioneve të pavarura me performancë të lartë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Shumica e cilësuar nuk përbën garanci për pavarësi, pasi partitë e mazhorancës dhe opozitës mund të arrijnë marrëveshje që politizojnë institucionet e pavarura.</li> <li>■ Propozimi shton në mënyrë të panevojshme shanset për krizë politike nëse palët nuk arrijnë të zgjedhin titullarin e një institucioni mbikëqyrës të caktuar.</li> <li>■ Pavarësia e titullarit të institucionit nuk përmirëson domosdoshmërisht mbikëqyrjen pa kompetenca dhe forma të qarta për mbikëqyrjen parlamentare.</li> </ul>

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
T'i mundësohen opozitës më shumë burime njerëzore për të ushtruar kontrollin dhe mbikëqyrjen e qeverisë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Rritet besimi i publikut në punën e Kuvendit dhe përmirësohet performanca e funksionit mbikëqyrës të parlamentit</li> <li>■ Mbështetet puna e institucioneve të tjera në rastin e komisioneve hetimore të Kuvendit (p.sh. gjykata, prokuroria)</li> <li>■ Përmirësohet cilësia e ligjeve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Rritja e numrit të stafit mbështetës nuk është e thënë se përmirëson domosdoshmërisht performancën e parlamentit pasi opozita mund ta keqpërdorë atë për kauzat e saj politike</li> <li>■ Diskriminohen partitë e tjera politike dhe deputetët e shumicës në pushtet, të cilët mund të jenë të prirur për të përmirësuar mbikëqyrjen parlamentare.</li> </ul>

## ANGAZHIMI I QYTETARËVE

### KONTEKSTI

Raporte të ndryshme konstatojnë se pjesëmarrja qytetare në Shqipëri është në rënie dhe shumë njerëz ndihen të papërfaqësuar. Një faktor që kontribuon në këtë situatë është mungesa e instrumenteve dhe mundësive për të kanalizuar kontributin e qytetarëve në demokraci dhe për të trajtuar çështjet që i shqetësojnë ata. Mundësi të tilla lehtësohen nga instrumentet ligjore që qytetarët mund t'i përdorin në përpjekjet e tyre për demokraci, siç janë ligjet që rregullojnë të drejtën e tyre për të mbajtur një referendum dhe për t'i drejtuar një petition parlamentit.

Kushtetuta e Shqipërisë njih zyrarisht të drejtën e popullit për të ushtruar sovranitetin e tij me anë të referendumeve. Megjithatë, në tridhjetë vitet e fundit që nga rënia e komunizmit në Shqipëri janë mbajtur vetëm tre referendume, të gjitha organizuara me nismën e partive politike gjatë viteve '90, ku më i fundit u mbajt në vitin 1998 për miratimin e Kushtetutës së Shqipërisë. Neni 150 i Kushtetutës parashikon miratimin e një ligji për referendumet. Megjithatë, Kuvendi ende nuk ka miratuar ndonjë ligj sipas detyrimit kushtetues, përveç disa ndryshimeve në Kodin Zgjedhor (2003), të cilat shqyrtojnë rolin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në organizimin e një referendumi. Që nga viti 2020, është depozituar në Komisionin Parlamentar të Ligjeve një projektligj për referendumet, i përgatitur nga një organizatë e

shoqërisë civile dhe i mbështetur nga një deputet.

Pavarësisht mungesës së një ligji për referendumet, shoqëria civile ka ndërmarrë disa përpjekje, edhe pse të pasuksesshme, për të bërë referendume. Përvoja më e suksesshme daton në vitin 2013 me nismën për ndryshimin e ligjit për mbetjet, nismë që kaloi pragun ligjor prej 50,000 nënshkrimesh, por që ligji në fjalë u shfuqizua në tetor 2013 nga mazhoranca e re në Kuvend.

Lulëzimi i teknologjisë dhe dixhitalizimi prezantuan forma dhe mjete më efikase të pjesëmarrjes qytetare, më i përhapuri prej të cilëve është peticioni online për çështje të ndryshme politike që kanë rëndësi për publikun. Ndonëse këto nisma shpesh marrin mbështetje të gjerë popullore, në pjesën më të madhe të rasteve, ato nuk merren parasysh nga Parlamenti dhe pothuajse asnjëherë nuk arrijnë të ndikojnë në programin politik të vendit. Për këtë qëllim, është me rëndësi parësore hartimi i një ligj që e kanalizon këtë energji në një formë efikase të pjesëmarrjes politike. Një mënyrë për ta bërë këtë është përcaktimi i peticionit online si instrument i votuesve për të ndikuar në planin e punës së Kuvendit, duke i detyruar deputetët të debatojnë në seancat plenare për çështje që kanë marrë mbështetje të mjaftueshme popullore online (d.m.th. që kanë kaluar pragun ligjor). Gjithsesi, legjislacioni aktual për nënshkrimet elektronike (d.m.th. Ligji 9880) ia ka dhënë me kontratë këtë shërbim një kompanie private, e cila ka kosto shumë të larta për mbledhjen e mijëra nënshkrimeve (rreth 2 dollarë për nënshkrim) duke u bërë kështu një pengesë serioze për shfrytëzimin e kësaj mundësie.

PROPOZIMI DHE ARGUMENTET PRO DHE KUNDËR

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<p><b>T'u mundësohet zgjedhësve që të nënshkruajnë peticione online dhe të detyrojnë parlamentin të diskutojë për çështje të rëndësishme për publikun.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Përmirësohet mbikëqyrja parlamentare përmes rolit/ përfshirjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve.</li> <li>■ Bëhet mjet efikas që nxit përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe rrit besimin e publikut tek institucionet.</li> <li>■ Decentralizohet kontrolli mbi agjendën parlamentare dhe legislative duke fuqizuar qytetarët.</li> <li>■ Nxiten parlamenti dhe partitë politike të trajtojnë shqetësimet/çështjet e qytetarëve për të cilat partitë politike kanë kundërshti ose hezitim</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Rrezikon të manipulohet nga partitë politike dhe/ose grupet private të interesit.</li> <li>■ Ndonëse Kuvendi mund të shqyrtojë çështjen për të cilën është nënshkruar një peticion online, ai nuk mund të vendosë domosdoshmërisht në favor të tyre.</li> <li>■ Manipulimi i këtij instrumenti nga partitë politike mund të thellojë hendekun dhe të rrisë nivelin e mosbesimit të publikut ndaj institucioneve.</li> </ul>
<p><b>Parashikimi i një buxheti (fonde publike) të veçantë për të mbuluar kostot e nisjes së një referendumit apo nismës ligjore qytetare.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Mbulimi i kostove të nismave qytetare i bën instrumentet e demokracisë së drejtpërdrejtë më të aksesueshme për votuesit.</li> <li>■ Fondi garanton se nisma të tilla nuk kushtëzohen plotësisht nga burimet financiare që kanë në dispozicion grupet e pasura të interesit, partitë politike apo edhe individë të pasur.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Fondet publike u hiqen shërbimeve të tjera publike, dhe ndoshta çështjeve më urgjente sociale dhe ekonomike</li> <li>■ Fondi dhe instrumentet mund të keqpërdoren nga grupet e interesit për të zhvilluarmë tej me interesat e tyre.</li> </ul>
<p><b>Vendosja e detyrimit për të organizuar referendume për çështje të rëndësishme.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Forcohet demokracia e drejtpërdrejtë, angazhimi i qytetarëve dhe besimi i publikut tek institucionet.</li> <li>■ Merren vendime për çështje të rëndësishme që nuk ndikohen nga interesat konkurruese të grupeve politike apo të biznesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Shqipëria nuk ka një kulturë të mirëfilltë e të konsoliduar të demokracisë së drejtpërdrejtë si shoqëritë e tjera në Evropë (p.sh. Zvicra), prandaj interesi (pjesëmarrja e votuesve) mund të jetë i ulët.</li> <li>■ Rrit në mënyrë të panevojshme kostot publike për çështje që mund të trajtohen me procedura më pak të kushtueshme.</li> </ul>

## DEMOKRACIA E BRENDSHME E PARTIVE POLITIKE

### KONTEKSTI

Partitë politike shqiptare zhvillohen kryesisht rreth kryetarit, ndërkohë që kritikën ose pikëpamjet e kundërta shpesh kanë çuar në fraksione jetëshkurtra, të cilat bëhen një kopje shumë e ngjashme e partisë nga e cila rrjedhin.<sup>3</sup> Këto parti lindën më shumë si reagim ndaj ambicieve personale apo mosmarrëveshjeve midis kryetarit ekzistues të partisë dhe kryetarit të partisë së re sesa nga pikëpamje të thella ballafaqese mbi parimet politike apo demokratike.<sup>4</sup>

Janë bërë shumë pak përpjekje për të garantuar lirinë e fjalës, pikëpamjet e ndryshme apo konkurrencën e ndershme brenda partisë.<sup>5</sup> Në

dokumentet e tyre statutore, partitë politike pretendojnë garanci të plotë për të respektuar kritikën, për të mundësuar vendimmarrjen e bazuar vetëm në votim, për të pranuar ide të reja dhe të ndryshme, për të nxitur kandidimin për poste drejtuese dhe për të lejuar hyrje e dalje të lirë nga partia. Gjithsesi, praktika na tregon një tjetër realitet.

Që nga rënia e komunizmit, 15 parti politike janë krijuar si efekt anësor i sanksioneve, kufizimeve dhe përjashtimeve brenda PS dhe PD. Debatet publik, deklaratat dhe sjellja politike e partive të reja dhe e kryetarëve të tipit të vjetër kanë dëshmuar shkallën e vogël të efektivitetit të pluralizmit brenda partive dhe se sa e brishtë është demokracia e tyre e brendshme. Tabela e mëposhtme tregon derivatin kryesor të partive politike në Shqipëri, me origjinë nga dy partitë kryesore.

Tabela 1: Partitë e reja politike që lindën nga partitë kryesore PS dhe PD në Shqipëri, 1991 – 2021.

Partitë që lindën nga Partia Socialiste	Partitë që lindën nga Partia Demokratike	Viti
Partia Social Demokrate (PSD)		1991
	Partia Aleanca Demokratike (PAD)	1992
	Partia për Demokraci dhe Drejtësi (PDD)	1995
	Rimëkëmbja (RK)	1995
Partia Socialiste e Vërtetë (PSV)		1996
	Partia e Re Demokratike (PDR)	2000
Partia Demokristiane (PDK)		2001
Partia Demokracia Sociale (PDS)		2003
Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)		2004
Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU)		2009
Partia Socialiste e Vërtetë '91 (PSV91)		2009
Partia Socialiste e Moderuar (PSM)		2011
	Fryma e Re Demokratike (FRD)	2012
	Lëvizja për Shqipërinë (LPSH)	2015
	Bindja Demokratike	2019
	Lëvizja për ndryshim	2021

....

- 3 Hackaj, A, Krasniqi, A (2017), Shqiptarët dhe modelit social evropian – demokracia e brendshme në partitë politike shqiptare, FES, Tirana.
- 4 Po aty.
- 5 Siç tregohet në statutin e tre partive kryesore, PD, PS dhe LSI, që ndryshojnë përkatësisht 5, 6 dhe 4 herë.



Fraksionet e shumta, të vazhdueshme dhe të paqëndrueshme pasqyrojnë pjesën thellësisht të fragmentuar të dy partive kryesore (PS dhe PD), si pasojë e mangësive në demokracinë e brendshme të tyre. Këto fraksione demonstrojnë edhe rritjen e ndikimit dhe të kontrollit të kryetarëve autoritarë të këtyre partive.

## SHENJA TË KONTROLLIT DHE PUSHTETIT NË PARTITË POLITIKE

Rënia e rolit dhe rëndësisë së anëtarëve dhe mbështetësve të partisë është shenja më e dukshme e stilit autoritar të udhëheqjes së partisë në Shqipëri. Një tjetër shenjë e tillë është roli i kryetarit të partisë në emërimet e rëndësishme në parti dhe të kandidatëve për deputetë, kryetarë të bashkive, këshilltarë apo pozita të tjera të rëndësishme dhe në poste shtetërore. Shumica dërrmuese e këtyre zyrtarëve emërohen drejtpërdrejt nga kryetari i partisë nga rrethi i njerëzve të besuar.

Partitë politike shqiptare mbështeten

jashtëzakonisht shumë në vendimmarrjen vertikale (nga lart poshtë) dhe jo në atë horizontale me anë të së cilës fuqizohen anëtarët. Ka dallim të madh edhe mes dispozitave ligjore në letër (Ligji "Për partitë politike", statutet dhe rregulloret e partive, Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor) dhe zbatimit të tyre në praktikë. Në disa aspekte, pothuajse të gjitha partitë politike në Shqipëri veprojnë në kundërshtim me ligjin në raste të tilla si anashkalimi i zgjedhjeve periodike të brendshme, mosushtrimi i demokracisë funksionale, lejimi i identifikimit të besimit fetar dhe përkatësisë etnike, etj.

Shqipëria ka arritur të përvetësojë veçse një përvojë modeste në jetën e saj demokratike. Mungesa e një tradite të konsoliduar demokratike ka ushqyer tipare negative të demokracisë së brendshme të partive politike, së bashku me tendencën për të krijuar shumicë absolute, parti të forta dhe kryetarë të fortë me pushtet absolut, me privilegje dhe kompetenca të pakundërshtuara. Si pasojë, modeli dominues i partive në Shqipëri është ai i lidhur me kryetarin dhe një parti pa struktura funksionale sipas standardeve të demokracisë.

## PROPOZIMI DHE ARGUMENTET PRO DHE KUNDËR

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<b>Të vendosen mekanizma konkurrimi brenda partive politike (p.sh., primaret e kandidatëve për zgjedhjet vendore dhe kombëtare).</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Përmirësohet besimi i publikut tek partitë politike (tradicionalisht më pak të besuara nga shqiptarët)</li> <li>■ Anëtarët e partive politike ndihen më të angazhuar dhe të fuqizuar</li> <li>■ Karriera politike brenda partisë lidhet më ngushtë me qytetarët dhe bazën e partisë, sesa me preferencat e liderit të partisë.</li> <li>■ Ulet përqendrimi i pushtetit në duart e liderit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Është një instrument i kushtueshëm që mund të zhvendosë fokusin e partive dhe anëtarëve drejt sigurimit të fondeve, dhe jo te meritokracia apo demokracia e brendshme.</li> <li>■ Primaret mund të shkaktojnë përçarje ose të thellojnë ato ekzistuese brenda partive përpara zgjedhjeve vendore/parlamentare.</li> <li>■ Mund të forcohen degët lokale të partive politike por jo domosdoshmërisht veprimet e tyre në nivel kombëtar</li> <li>■ Nuk nxjerr domosdoshmërisht në plan të parë rolin e strukturave të partisë</li> </ul>

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<b>Të rritet financimi publik për partitë dhe kandidatët</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Fondet publike i bëjnë partitë politike dhe kandidatët e tyre më pak të varur nga financimet private (që shpesh vijnë me kushte për të përmbushur interesa private).</li> <li>■ Financimi publik i bën partitë politike më të përgjegjshme, pasi financat e tyre do të shqyrtohen, nëse është e nevojshme, edhe nga autoritete gjyqësore.</li> <li>■ Financimi publik bën që fokusi i partive politike të jetë i drejtuar tek problemet dhe politikat dhe jo në mbledhjen e fondeve për fushatë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Partitë politike mund të abuzojnë me fondet publike</li> <li>■ Nuk është e thënë që financimi publik t'i bëjë partitë më pak të varura nga ndikimi dhe interesat private.</li> <li>■ Fondet publike u hiqen shërbimeve të tjera publike, dhe ndoshta çështjeve më urgjente sociale dhe ekonomike.</li> </ul>
<b>Të certifikohen financat e partive politike nga kompani ndërkombëtare.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Bën të mundur integritet më të lartë të financave të partive politike.</li> <li>■ Përmirësohet besimi i publikut tek partitë politike</li> <li>■ Mund të nxitet një kulturë donacionesh për partitë politike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Kostot janë shumë më të larta se të kompanive vendase dhe do të duhet të garantohen nga buxheti i shtetit.</li> <li>■ Kjo masë diskriminon bizneset vendase të auditimit.</li> </ul>

## SISTEMI ZGJEDHOR

### KONTEKSTI

Sistemi zgjedhor është një nga shtyllat kryesore të sistemit politik të çdo vendi. Ai përkthen preferencat individuale politike të votuesve në një zgjedhje të vetme: një parlament i cili përfaqëson të gjithë vendin. Sistemi zgjedhor përcakton çështje thelbësore të tilla si: kriteri i përfaqësimit; përmasa e parlamentit; përmasa e zonave zgjedhore; sistemin e votimit; kush mund të zgjidhet dhe rregullat e tjera të konkurrimit politik. Për këtë qëllim, reformat zgjedhore duhet të hartohen dhe zbatohen me kujdes. Shqipëria ka bërë tetë reforma zgjedhore që nga rënia e komunizmit. Thuajse të gjitha reformat janë bërë me ngut, brenda një kohe të shkurtër, pa transparencë dhe pa përfshirjen e publikut.

Sistemet zgjedhore kanë tre elemente kryesore:

1. Struktura e votës: si dhe për kë do të votojë elektorati?
2. Përmasa e zonës zgjedhore: në sa zona zgjedhore është i ndarë vendi, përfshirë sa vende në parlament i përkasin çdo zone zgjedhore?
3. Formulën elektorale: mënyrën si votat e fituara nga një subjekt përkthehen në vende në parlament.

Nisur nga struktura e votës, sistemet zgjedhore ndahen në dy grupime të mëdha, brenda të cilave ka variacione të shumta:

- a) **sistemi mazhoritar**, në të cilin votuesit votojnë drejtpërsëdrejti për të zgjedhur

përfaqësuesin e tyre në parlament. Në këtë sistem, vendi ndahet në atë zonë zgjedhore sa vende ka në parlament dhe në çdo zonë zgjidhet një deputet mes disa kandidatëve që garojnë në secilën zonë zgjedhore.

- **b) sistemi proporcional**, në të cilin votuesit votojnë për të zgjedhur partinë që preferojnë, dhe vendet në parlament shpërndahen mes partive në përputhje me përqindjen e votës që partitë kanë marrë në zgjedhje. Emrat e përfaqësuesve që zënë vendet e fituara nga partia në parlament i përcaktojnë partitë politike, përmes listave të kandidatëve për deputetë të hartuara prej tyre.

**Sistemet e përziera** janë ato që kombinojnë të dy sistemet e mësipërme: një pjesë e përfaqësuesve në parlament zgjidhet me votim direkt mazhoritar dhe një pjesë nga votimi për partitë politike. Ky sistem ka qëllim kryesor që të kombinojë më të mirën e dy sistemeve: votuesit të zgjedhin direkt përfaqësuesin e tyre, por edhe partitë politike të përfaqësohen në parlament në raport me mbështetjen popullore që ato gëzojnë në elektorat.

Sistemi mazhoritar ka prirjen të shtrembëroje vullnetin e popullit. Teorikisht, një parti mund të fitojë në çdo zonë mazhoritare me 51% të votave, ndërkohë një tjetër të humbë në secilën nga këto zona me 49% të votave. Si rezultat, në këtë shembull hipotetik, parlamenti do të përbëhej 100% me deputetët e partisë së parë, ndërkohë që partia e dytë do të ketë 0% të vendeve në parlament, edhe pse gëzon 49% të votës popullore. Një shtrembërim i tillë, natyrisht në nivele më të vogla se shembulli teorik, vihet re në çdo sistem mazhoritar. Prandaj për të kompensuar këtë shtrembërim përdoret sistemi i përzier, i cili përmes votimit proporcional i mundëson partisë së dytë që të marrë një përqindje të vendeve në parlament, duke iu afuar kështu përqindjes së votave të fituara në elektorat.

Në 30 vitet e fundit Shqipëria i ka provuar të tre llojet e sistemeve zgjedhore. Në fillim të tranzicionit (viti 1991) sistemi zgjedhor ka qenë mazhoritar. Vendi ishte i ndarë në 140 zona elektorale dhe në çdo zonë votuesit zgjidhnin një përfaqësues duke votuar për një nga disa kandidatë që garonin për t'u bërë deputetë në Kuvend. Nga vitit 1992 deri në vitin 2008, Shqipëria ka pasur sistem të përzier, 100 deputetë zgjidheshin direkt përmes votimit mazhoritar në 100 zona zgjedhore, ndërsa 40

deputetë të tjera zgjidheshin përmes votimit të partive politike.

Nga viti 2009, zgjedhjet janë zhvilluar me sistem proporcional. Votuesit votojnë partitë politike, ndërsa emrat e deputetëve vendosen nga partitë përmes listave të kandidatëve.

Tiparet kryesore të sistemit të tanishëm zgjedhor janë:

1. Shqipëria ka sistem rajonal zgjedhor, ku në secilën zonë zgjedhore votimi dhe rezultati është i pavarur nga zonat e tjera. Vendi është i ndarë në 12 zona zgjedhore, secila me një numër të veçantë deputetësh, nga zona më e vogël, Kukësi, me tre deputetë, tek zona më e madhe zgjedhore, Tirana, më 36 deputetë.
2. Numri i vendeve në parlament që i takojnë partive politike për çdo zonë zgjedhore caktohet afërsisht në mënyrë proporcionale me përqindjen e votave të marra nga partia në atë zonë.
3. Caktimi i emrave të deputetëve për çdo parti bëhet me anë të listave të kandidatëve. Para zgjedhjeve çdo parti apo koalicion i partive që garon si subjekt i vetëm zgjedhor paraqet një listë të renditur të kandidatëve për deputetë për çdo zonë zgjedhore. Shpërndarja e vendeve të çdo partie bëhet në bazë të kësaj liste: vendi i parë i sigurohet nga partia i shkon personit të parë në listën e saj të kandidatëve, i dyti i shkon të dytit të listës e me radhë deri sa plotësohen të gjitha vendet e fituara nga partia në çdo zonë zgjedhore.
4. Që një parti të marrë vende në Kuvend do të duhet që të sigurojë në të gjithë vendin të paktën 1% të numrit total të votave të vlefshme në zgjedhje.
5. Në një zonë të caktuar zgjedhore mund të garojnë edhe kandidatë të pavarur nëse ata sigurojnë firmat e 1% të votuesve në listat e zgjedhësve të zonës ku do garojnë. Që të fitojnë një vend në Kuvend, kandidatët e pavarur do të duhet jo vetëm të fitojnë numrin e nevojshëm të votave në zonën zgjedhore për të siguruar vendin si subjekt zgjedhor, por duhet që të plotësojnë edhe kushtin e pragut 1% të totalit të votave në rang vendi.

Sistemet proporcionale ndahen në dy grupe të mëdha: në sisteme me lista të hapura dhe në ato me lista të mbyllura. Në sistemet proporcionale me lista të mbyllura, partitë politike paraqesin një listë kandidatësh me renditje të përcaktuar, nga i pari tek i fundit, e cila nuk mund të ndryshohet nga votuesit. Votuesit votojnë vetëm për partinë dhe nuk kanë asnjë ndikim në përcaktimin se kush nga kandidatët e listës së partisë bëhet deputet.

Në sistemin proporcional me lista të hapura, lista e kandidatëve është e pa renditur, dhe ajo renditet në bazë të preferencës së votuesve. Votuesit votojnë për partinë, por ata kanë të drejtë që të shprehin preferencën e tyre duke votuar për një ose disa kandidatë nga lista e partive që kanë zgjedhur.

Pas votimit, lista e kandidatëve të partisë renditet në bazë të votave që ka marrë secili kandidat dhe shpërndarja e vendeve të partisë mes kandidatëve bëhet në bazë të kësaj renditjeje: kandidati që ka marrë më shumë vota nga votuesit merr vendin e parë në parlament të fituar nga partia në zonën përkatëse, i dyti merr vendin e dytë e kështu me radhë deri sa plotësohen të gjitha vendet.

Sistemi i tanishëm shqiptar është një përzjerje e veçantë mes listave të mbyllura dhe të hapura. Ky është tipari tjetër i sistemit tonë zgjedhor: Në këtë sistem listat partiake janë të renditura paraprakisht nga partitë politike, por votuesit kanë mundësi ta ndryshojnë këtë renditje me votën e tyre, por vetëm në rastet kur mbështetja e tyre është e madhe për ndonjë kandidat të renditur jashtë zonës fituese.

Që një kandidat i renditur më poshtë se pjesa jo fituese e listës së një partie të marrë një vend në Kuvend duhet që ai/ajo të marrë vota preferenciale nga votuesit më shumë se sa mesatarja e votave që partia ka marrë për çdo vend që ka siguruar në Kuvend në zonën përkatëse. Pra, duhet të marrë të paktën një votë më shumë se herësi që përftohet nga pjesëtimi i numrit total të votave që ka fituar partia me numrin e mandateve parlamentare që ka marrë partia në zonën përkatëse. Në një rast të tillë, kandidati zëvendëson kandidatin e renditur të fundit në zonën fituese të listës partiake.

Edhe pse Kushtetuta e Shqipërisë përcakton se të paktën dy të tretat e listave të kandidatëve duhet të renditen në bazë të votës parapëlqyese të votuesve, mekanizmi i mësipërm nuk garanton një gjë të tillë, pasi vetëm një numër shumë i vogël kandidatësh mund të arrijnë të marrin aq vota sa nevojiten në zgjedhjet e prillit 2021, vetëm tre kandidatë nga

rreth 500 kandidatë të tre partive kryesore arritën që të marrin më shumë vota se herësi partiak dhe morën mandatin e deputetit.

## Problemet e sistemit zgjedhor të tanishëm

Sistemi zgjedhor i tanishëm ka shkaktuar një sërë problemesh:

1. Shtrembërimi i proporcionalitetit dhe klientelizmi. Tipari i rajonalizimit shtrembëron përfaqësimin. . Për të kuptuar këtë problem mjafton ta ilustrojmë me disa fakte: Për të siguruar një deputet, dy partive të mëdha PS dhe PD dhe partisë lokale PSD iu deshën mesatarisht midis 10-12 mijë vota, ndërsa LSI-së iu deshën më shumë se dy herë më shumë, mbi 25 mijë vota. PSD, duke u përqendruar në Shkodër, mori atje dy deputetë me pak më shumë se 16 mijë vota, pra afërsisht 8 mijë vota për deputet. Ndërkohë Nisma Thurje, e shtrirë në të gjithë Shqipërinë, nuk mori asnjë deputet edhe pse mori 10 mijë vota në total. LSI mori në të gjithë vendin mbi 107 mijë vota dhe vetëm 4 deputetë, ndërkohë që PSD me rreth 35 mijë vota në total, duke u përqendruar vetëm në Tiranë dhe Shkodër mori tre deputetë.

Përveçse shtrembërimin të ndjeshëm të parimit të përfaqësimit, rajonalizimi krijon motivim për klientelizëm: partitë apo drejtues të tyre kanë më shumë mundësi të sigurojnë mandate duke u premtuar favore një lokaliteti të caktuar sidomos në zona rurale ku lidhjet familjare dhe personale janë më të forta.

2. Dobësim i garës zgjedhore. Partitë kanë ndërtuar në vite një elektorat të sigurt që nuk ndryshon nga zgjedhja në zgjedhje. Për rrjedhojë, në çdo zgjedhje ato kanë të garantuar një numër minimal deputetësh. Gara bëhet vetëm për pak mandate, të cilat mund t'i shkojnë secilës nga partive që konkurrojnë. Marrim shembullin e Kukësit që ka tre deputetë. Në çdo zgjedhje që nga viti 2009, PD ka marrë 2 deputetë në Kukës dhe PS ka marrë 1 deputet. Pra, 3 mandatet në Kukës dihen që përpara votimit se kujt partie do i shkojnë. Dy kandidatët e parë në listën e PD-së dhe i pari në listën e PS-së e kanë të sigurt që zgjidhen, të tjerët në listat e tyre dhe të partive të tjera e kanë të pamundur. Në Kukës nuk ka praktikisht garë zgjedhore.

3. Sistemi është i ndërlikuar për votuesit. Mekanizmi se si mund të ndryshohet renditja partiake është shumë pak i kuptuar nga votuesit. Një sërë vrojtimesh të opinionit kanë zbuluar se qytetarët e kuptojnë se nëse një kandidat i renditur ulët në listën partiake

fiton shumë vota ai mund të bëhet deputet, por mekanizmi dhe kushtet e sakta të kësaj përmbysje janë të paqarta për ta.

## PROPOZIMI DHE ARGUMENTET PRO DHE KUNDËR

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<b>Kalimi nga sistemi aktual proporcional rajonal në sistemin proporcional kombëtar (me vetëm një listë kombëtare).</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Sistemi kombëtar e trajton çështjen e proporcionalitetit duke hequr “dënimin” që ky sistem u bën partive të tjera politike, përveç dy partive kryesore. Me një sistem të tillë kombëtar, numri mesatar i votave për deputet në Kuvend është pothuajse i barabartë mes të gjitha partive që sigurojnë vende në Kuvend. Për këtë arsye, ky sistem është më i ndershëm dhe më i paanshëm me të gjitha partitë politike.</li> <li>■ Ky sistem zhdok favorizimin që u bëhet aktualisht partive lokale në kurriz të partive të vogla kombëtare, duke dobësuar kështu tendencat klienteliste të nxitura nga sistemi aktual.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Sistemi kombëtar dobëson lidhjet e drejtpërdrejta mes votuesve dhe deputetëve/kandidatëve.</li> <li>■ Vëmendja e sistemit kombëtar dhe e deputetëve tek audiencia kombëtare e votuesve mund të krijojë distancë nga çështjet dhe shqetësimet që kanë komunitetet e ndryshme vendore.</li> <li>■ Në sistemin kombëtar, partitë politike fitojnë vlerë shtesë si përfaqësuese të elektoratit, në krahasim me deputetët si individë, duke forcuar kështu edhe rolin e partisë në dëm të rolit të deputetëve.</li> </ul>
<b>Kalimi tek listat plotësisht të hapura në sistemin aktual zgjedhor.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Do të zbutet e ashtuquajtura presidentokraci partiake: dominimi i partive nga lideri i tyre, për shkak të fuqisë së tij de facto për të përcaktuar emrat dhe renditjen në listat e partisë.</li> <li>■ Do të rritet edhe konkurrenca dhe demokracia e brendshme e partive politike.</li> <li>■ Nga ana tjetër, do të forcohet edhe lidhja mes kandidatëve dhe votuesve, pasi fati i garës do të vendoset kryesisht nga votuesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Ky sistem mund të prodhojë diferenca tejet të mëdha në numrin e votave që merr një kandidat për të siguruar një vend (“super deputetë” që marrin shumë vota, siç janë drejtuesit kryesorë të partive).</li> <li>■ Do të krijohet një konkurrencë e fortë mes kandidatëve të partisë për të marrë sa më shumë vota, gjë që mund të krijojë një situatë jo të shëndetshme brenda partisë dhe të dëmtojë shanset e partisë për të fituar zgjedhjet.</li> </ul>

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<b>Rikthimi në sistemin e mëparshëm zgjedhor me zgjedhjen e 100 deputetëve me sistem mazhoritar dhe 40 me sistem proporcional.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Ky sistem tenton të sjellë më të mirën e këtyre dy botëve: zgjedhjen e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve dhe lidhjen e drejtpërdrejtë mes votuesve dhe përfaqësuesve të tyre, duke siguruar kështu që partitë të përfaqësohen në Kuvend në raport me votën e tyre popullore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Problemi kryesor i këtij sistemi është se mundëson votimin strategjik: dy partitë e mëdha nuk kanë gjasa që të përfitojnë nga 40 mandatet proporcionale (duke qenë se numri i deputetëve që ato fitojnë në mazhorancë është zakonisht proporcionalisht më i madh se përqindja e votave proporcionale që këto parti marrin në zgjedhje). Partitë e mëdha krijojnë koalicione me parti më të vogla dhe u kërkojnë votuesve të tyre të votojnë për aleatët e tyre më të vegjël në votimin për partitë politike, për të bërë të mundur që vendet nga vota proporcionale të merren nga aleatët e tyre.</li> </ul>
<b>Kalimi në sistem të pastër mazhoritar (deputeti i çdo zone zgjidhet me shumicën e votave të qytetarëve).</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Kështu do të krijohet një lidhje e drejtpërdrejtë mes votuesve dhe përfaqësuesve të tyre</li> <li>■ Do të sigurohet një cilësi më e mirë e kandidatëve, pasi do të rritet konkurrenca mes kandidatëve në të gjithë vendin.</li> <li>■ Do të përmirësohet demokracia e brendshme e partive, pasi roli i udhëheqjes së partive në emërimin e kandidatëve do të jetë më i dobët: çdo kandidat mund të sfidojë vendimin e udhëheqjes së partisë për të emëruar një kandidat jopopullor, duke vendosur të kandidojë si i pavarur.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Argumenti kryesor kundër një sistemi të pastër mazhoritar është se ai deformon përfaqësimin e partive në Kuvend. Teorikisht, në rastin ekstrem, një parti e vetme politike mund të marrë të gjitha vendet në Kuvend me vetëm 51 për qind të votave popullore.</li> </ul>

## VOTA E DIASPORËS

### KONTEKSTI

Shqipëria është vendi me një nga diasporat më të mëdha në botë. Më shumë se një e treta e shtetasve të saj jetojnë në mënyrë të përhershme jashtë vendit. Sipas të dhënave të INSTAT, mbi 36% e rreth 4,4 milionë shtetasve shqiptarë jetojnë jashtë Shqipërisë: brenda jetojnë rreth 2,78 milionë shtetas, ndërsa jashtë jetojnë rreth 1,64 milionë shtetas.

Për shkak të shtetësisë, shqiptarët që jetojnë jashtë Shqipërisë kanë të drejtën të votojnë në zgjedhje. Kushtetuta i njehtë drejtën universale për të votuar të gjithë shtetasve të Shqipërisë, ndërsa Kodi Zgjedhor specifikon se të drejtën e ushtrojnë të gjithë shtetasit mbi 18 vjeç, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Kodi Zgjedhor përcakton se për të ushtruar të drejtën e votës, shtetasit duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile; dhe të kenë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit.

Si rezultat, shumë prej shqiptarëve që jetojnë jashtë janë të regjistruar në një qendër votimi, zakonisht në atë ku ka qenë banesa e fundit e tyre para i migrimit. Kjo është arsyeja pse në listat e votimit janë rreth 3.6 milionë votues edhe pse në Shqipëri jetojnë më pak se 2.8 milionë banorë.

Në fakt, rreth 1.3 milionë nga shtetasit që jetojnë jashtë vendit janë në moshë votimi. Ata përbëjnë rreth 38% të afërsisht 3.6 milionë votuesve të regjistruar në listat e votimit në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021.

Por pavarësisht se ata gëzojnë të drejtën e votës dhe mund të jenë të regjistruar në Regjistrin e Zgjedhësve, e vetmja mënyrë e tyre për ta ushtruar të drejtën e votës është të vijnë fizikisht për të votuar në Shqipëri. Shqiptarët që jetojnë jashtë Shqipëri së mund të ushtrorjnë të drejtën e votës vetëm nëse janë të regjistruar në një qendër votimi në Shqipëri dhe vetëm duke ardhur në Shqipëri për të votuar.

Me reformën zgjedhore të vitit 2010, Kodi Zgjedhor rikonfirmoi se shtetasve që jetojnë jashtë vendit duhet t'u garantohet ushtrimi i të drejtës së votës. Kodi Zgjedhor ia ngarkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) detyrën për të hartuar rregullat teknike të votimit të emigrantëve nga jashtë vendit dhe për të ndërtuar të gjithë infrastrukturën përkatëse. Çështja e votimit të diasporës është një çështje delikate, e cila mund të arrihet vetëm me një konsensus të gjerë politik dhe shoqëror. Prandaj, rregullat dhe mënyra e votimit e diasporës kërkon një konsensus të gjerë dhe jo thjesht vendim marrjen e KQZ-së. Që zgjedhjet të jenë legjitime, do të duhet që të ketë dakordësi paraprake mes të gjithë aktorëve politikë dhe publikut të gjerë se sistemi është i ndershëm dhe i paanshëm. Kjo gjë kërkon konsensus për mënyrën e regjistrimit të tyre, për mënyrën e votimit dhe të numërimit të votës së tyre. Ka nevojë edhe për konsensus se ku do të llogariten votat e diasporës.

## Pse duhet mundësuar vota e Diasporës?

1. Është ushtrim i një të drejte kushtetuese. Duhet theksuar se bëhet fjalë për të mundësuar ushtrimin e një të drejte dhe jo për të dhënë një të drejtë : çdo shtetas shqiptar, pavarësisht se ku jeton, ka të drejtë të votojë. Çështja është a duhet të investojë Shqipëria që të mundësojë votimin nga jashtë vendit të shtetasve të saj. Emigrantët shqiptarë që nuk janë shtetas të një vendi tjetër, praktikisht nuk ka në mundësi të ushtrorjnë të drejtat e tyre politike.
2. Emigrantët kontribuojnë për Shqipërinë. Emigrantët kanë qenë dhe mbeten kontribues të mëdhenj në ekonominë dhe zhvillimin e Shqipërisë. Në tre dekadat e fundit, vendi ynë e është mbështetur, më shumë se çdo gjë tjetër, nga emigrimi i shqiptarëve. Në periudhën 1992-2020, totali i remitancave është rreth 30 miliardë dollarë, pra mesatarisht mbi 1 miliardë dollar në vit. Kjo shumë është më e madhe se kontributi individual në taksa i shqiptarëve brenda vendit.

## Vota e Diasporës – Si votohet nga jashtë vendit në botë?

Ka një shumëllojshmëri metodash votimi që zbatohen nga vende të ndryshme të botës, të cilat shpjegohen më poshtë.

*Votimi në person:* Zgjedhësi duhet të shkojë në një vend specifik dhe të hedhë votën personalisht. Kjo mund të bëhet në misionet diplomatike apo vende të posaçme të hapura jashtë vendit. Votimi në person ë shtë praktika më e zakonshme. . Votimi zhvillohet zakonisht në misionet diplomatike apo vende të tjera zyrtare. Këtë mënyrë e përdorin 55 vende. Përparësia kryesore e kësaj metode është se siguron fshehtësinë e votës, dhe garanton se zgjedhja reflektohet në fletën e votimit.

*Votimi me postë:* Plotësohet fleta e votimit dhe postohet në shtetin e vetë. Mënyra dytë më e përdorur është votimi me postë: ka avantazh se mund të bëhet nga çdo vend por ka kosto të lartë dhe shërbim të ngadaltë postar. Plotë 25 vende ofrojnë vetëm këtë sistem. Është sistemi më i përdorur në Evropën Perëndimore.

*Votimi me delegim /prokurë:* Një zgjedhës që jeton jashtë vendit mund të delegojë një person për të

ushtruar të drejtën e votës për llogari të saj/tij.

*Votimi elektronik:* Zgjedhësi përdor internetin ose telefonin për të hedhur votën e saj/tij. Estonia është vendi tipik që e bën një gjë të tillë. Pak vende kanë filluar përdorimin e votës elektronike. Deri tani vetëm Estonia, Franca dhe Holanda ofrojnë votimin elektronik.

*Votimi me faks:* Dy vende, Australia dhe Zelanda e Re, lejojnë edhe votimin me faks në rrethana të caktuara. Rreth 27 vende kanë sisteme mikse. Gjashtë vende, si Australia, Belgjika, Estonia, Holanda, Zelanda e Re dhe Suedia, ofrojnë tre ose më shumë alternativa votimi.

## PROPOZIMI DHE ARGUMENTET PRO DHE KUNDËR

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<p><b>Qytetarëve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit duhet t'u mundësohet votimi për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri pranë misioneve tona diplomatike në shtetet e huaja.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Forcohen lidhjet e komunitetit të jashtëm me komunitetin politik kombëtar.</li> <li>■ Qytetarëve që jetojnë jashtë vendit u ofrohet mundësia e promovimit të agjendës së tyre legjislative.</li> <li>■ Qytetarët që jetojnë jashtë vendit mund të përfshihen drejtpërdrejt në debatet dhe proceset vendimmarrëse politike, për çështje me interes kombëtar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ U jepet pushtet vendimtar atyre që nuk jetojnë në Shqipëri dhe nuk ndërveprojnë drejtpërdrejt me qeverisjen dhe me pasojat e politikës, për të përcaktuar qeverisjen dhe politikën e vendit. Si përfundim: rezultati i zgjedhjeve dhe pushteti që do të vendoset në Shqipëri do të përcaktohet nga njerëz që nuk jetojnë në Shqipëri.</li> <li>■ Për emigrantët në vende si Kanada, SHBA, por edhe në Gjermani dhe Francë kjo mund të jetë e vështirë. Në këto vende, Shqipëria ka një ambasadë në kryeqytet dhe, në rastin më të mirë, një ose dy konsullata në qytete të tjera. Prandaj, emigrantët që nuk banojnë pranë këtyre qyteteve do t'u duhet të udhëtojnë distanca të gjata për të votuar.</li> <li>■ Shqetësimi për besueshmërinë politike. Në të shkuarën qeveritë janë akuzuar se kontrollojnë administratën publike dhe votimi në selitë diplomatike mund të krijojë mosbesim tek partitë politike në opozitë në lidhje me ndershmërinë e procesit të votimit dhe numërimit të votave.</li> </ul>



PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<p><b>Qytetarëve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit duhet t'u mundësohet votimi për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri me postë të zakonshme.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Çdo person që kërkon të votojë me anë të postës, i dërgohet një fletëvotimi me postë speciale/rekomande, me kostot e postës që mbulohen nga buxheti i shtetit. Kjo u mundëson të gjithë shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë vendit të ushtrjnë të drejtën e tyre të votës, pavarësisht pranisë së misionit diplomatik në vendin pritës apo jo.</li> <li>■ Forcohen lidhjet e komunitetit të jashtëm me komunitetin politik kombëtar.</li> <li>■ Qytetarëve që jetojnë jashtë vendit u jepet mundësia e promovimit të agjendës së tyre legislative</li> <li>■ Qytetarët që jetojnë jashtë mund të angazhohen drejtpërsëdrejti në debatet dhe proceset vendimmarrëse politike që janë me interes kombëtar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Votimi me postë mund të kushtojë deri në 30 milionë euro, nëse do të votonin deri në 1 milionë shtetas jashtë vendit, duke pasur parasysh se posta rekomande nga Evropa dhe SHBA-të kushton rreth 20-30 euro për dy dërgesa(çuarja dhe marrja e fletëvotimit)..</li> <li>■ U jepet pushtet vendimtar atyre që nuk jetojnë në Shqipëri dhe nuk ndërveprojnë drejtpërdrejt me qeverisjen dhe me pasojat e politikës, për të përcaktuar qeverisjen dhe politikën e vendit. Si përfundim: rezultati i zgjedhjeve dhe pushteti që do të vendoset në Shqipëri do të përcaktohet nga njerëz që nuk jetojnë në Shqipëri.</li> </ul>
<p><b>Qytetarëve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit duhet t'u mundësohet votimi elektronik për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Procesi i votimit administrohet lehtësisht dhe nuk kërkon burime njerëzore për administrimin e procesit</li> <li>■ Forcohen lidhjet e komunitetit të jashtëm me komunitetin politik kombëtar.</li> <li>■ Qytetarëve që jetojnë jashtë vendit u jepet mundësia e promovimit të agjendës së tyre legislative</li> <li>■ Qytetarët që jetojnë jashtë mund të angazhohen drejtpërsëdrejti në debatet dhe proceset vendimmarrëse politike për çështje me interes kombëtar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Ka kosto që lidhen me këtë opsion (p.sh. teknologjia, pajisjet), por ka edhe një sfidë që lidhet me besimin në votën elektronike, sfidë që duhet të kapërcehet.</li> <li>■ U jepet pushtet vendimtar atyre që nuk jetojnë në Shqipëri dhe nuk ndërveprojnë drejtpërdrejt me qeverisjen dhe me pasojat e politikës për të përcaktuar qeverisjen dhe politikën e vendit. Si përfundim: rezultati i zgjedhjeve dhe pushteti që do të vendoset në Shqipëri do të përcaktohet nga njerëz që nuk jetojnë në Shqipëri.</li> </ul>

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
Shqipëria duhet të sigurojë vende të dedikuara në parlament për të cilat diaspora shqiptare (qytetarët shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit) të votojë dhe të zgjidhet.	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Forcohen lidhjet e komunitetit të jashtëm me komunitetin politik kombëtar.</li> <li>■ Qytetarëve që jetojnë jashtë vendit u jepet mundësia e promovimit të agjendës së tyre legjislative</li> <li>■ Qytetarët që jetojnë jashtë mund të angazhohen drejtpërsëdrejti në debatet dhe proceset vendimmarrëse politike për çështje me interes kombëtar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Argumenti kryesor kundër këtij propozimi është se ndonëse do të sigurohen vota nga jashtë vendit, pesha e një votimi të tillë do të jetë më e dobët, duke qenë se nuk do të ketë asnjë efekt praktik në përcaktimin e fituesit të zgjedhjeve dhe si rrjedhojë edhe të politikave qeveritare.</li> <li>■</li> </ul>

## IMIGRIMI EKONOMIK NË SHQIPËRI

### KONTEKSTI

Gjatë tre dekadave të fundit, më shumë se 1.62 milionë shtetas shqiptarë, ose gati 40 % e totalit, jetojnë sot në mënyrë të përhershme në vende të tjera. Qindra mijëra të tjerë emigruan jashtë vendit dhe më pas u rikthyen në Shqipëri—një pjesë për të ri-emigruar sërish. Emigrimi i shqiptarëve pritet të vazhdojë me ritme të larta në vitet e ardhshme, kryesisht përmes rrugëve të ligjshme. Bashkimi familjar dhe emigrimi në kua drin e programeve të i migrimit të vendeve perëndimore janë dy mënyrat kryesore të emigrimit që largojnë nga vendi mijëra shqiptarë çdo vit.

Një nga arsyt kryesore të emigrimit mbetet mungesa e mundësive ekonomike. Shumë njerëz të punësuar janë të pakënaqur me nivelin e ulët të shpërblimit dhe pagave. Një sërë vrojtimesh të opinionit publik kanë zbuluar se ka një pakënaqësi të madhe për pagat në shumë kategori të punësuarish, veçanërisht në industrinë fasonë (prodhim tekstilësh, këpucësh, shërbime në qendra telefonike - call centers, etj.), ndërtim dhe agro-industri.

Së fundmi, e migrimi i personave me kualifikim të lartë është rritur eksponencialisht gjatë a dekadë s së fundit, ku çdo vit mijëra profesionistë aplikojnë për të emigruar. Si rezultat, në shumë sektorë të vendit kërkesa për punësim është më e lartë se oferta. Në këtë sfond emigrimi, shqiptarët po

ndeshen me një aspekt tjetër të migrimit: imigrimin, ardhjen në Shqipëri të shtetasve të huaj. Edhe pse një popull në përgjithësi emigrant dhe me përfitime të mëdha, imigrimi i të huajve në Shqipëri, veçanërisht nga vende të caktuara të botës, ka ngjallur ndjesi dhe qëndrime të paprovuara më parë dhe shpesh të debatueshme.

### Punëtorët e pakualifikuar dhe emigrimi tyre

Punëtorët e pakualifikuar janë ata që kanë aftësi të kufizuara apo vlerë ekonomike minimale për punën që kryejnë. Zakonisht ata përdoren në punët e përditshme të prodhimit që nuk varen nga aftësi apo mjeshtëri teknike.

Punëtorët e pakualifikuar zakonisht kanë arsim minimal, për shembull fillor, dhe nuk kanë përvojë të specializuar në ndonjë punë. Punëtorët e pakualifikuar zakonisht punësohen në këta sektorë: bujqësi, manifakturë, ndërtim, shërbime shtëpiake, dhe turizëm.

Një pjesë e madhe e shtetasve të vendeve të varfra përpiqen të emigrojnë drejt vendeve më të zhvilluara. Në pamundësi për të arritur vende perëndimore, të cilat kanë kushte më të rrepta imigrimi, banorët e vendeve të varfra janë të interesuar të punojnë në vende më pak të zhvilluara se P erëndimi, por me të ardhura ndjeshëm më të larta se në vendin e origjinës.

## Potenciali për imigrim në Shqipëri

Shqipëria mund të jetë një vend i përshtatshëm për imigrim ekonomik. Shqipëria ka të ardhura mesatare për frymë rreth 5,400 dollarë, rrogë minimale rreth 286 dollarë muaj dhe rrogë mesatare rreth 510 dollarë në muaj.

Me këto kushte ekonomike, vendi ynë mund të jetë tërheqës për shumë punonjës të pakualifikuar nga shumë vende të pazhvilluara apo në zhvillim .

Sektorët kryesorë të mëposhtëm në Shqipëri kanë mundësi punësimi për punëtorët e pakualifikuar:

- Industria fasone: Në sektorin fason punojnë 67 mijë persona, me pagë mesatare rreth 30 mijë lekë në muaj.
- Ndërtim: Të punësuar gjithsej në ndërtim janë afërsisht 47 mijë persona, me pagë mesatare për punonjësve të pakualifikuar 30-32 mijë lekë.
- Bujqësi: Të punësuar në bujqësi 450 mijë, ndërkohë që rroga mesatare e tyre varion nga 200-300 mijë lekë.
- Shërbimet shtëpiake, veçanërisht kujdesi për rritjen e fëmijëve: Është i paqartë sa është punësimi në këtë sektor i cili vepron kryesisht në mënyrë informale, por mes familjeve të pasura është konsoliduar zakoni i marrjes së punonjësve të huaj, kryesisht grave filipinase.

Aktualisht në Shqipëri ka një numër të vogël shtetasish të huaj të punësuar. Sipas të dhënave të administratës tatimore në janar 2020 në Shqipëri ishin të punësuar rreth 9,600 të huaj. Kjo shifër ra në rreth 8,600 në mars 2021, ose sa 1.2 % e numrit total të gjithë të punësuarve të ligjshëm në vend.

Shumica e të huajve të punësuar në Shqipëri janë me kualifikime të larta, mes tyre shumica janë sipërmarrës, investitorë, drejtues kompanish, punonjës të organizatave ndërkombëtare, etj.

Vitet e fundit, ka filluar imigrimi i punonjësve të pakualifikuar kryesisht në sektorin e shërbimeve shtëpiake dhe të ndërtimit, por numri aktual i tyre është pak mijëra.

## Propozimi për lehtësimin e imigrimit të punonjësve të pakualifikuar

Kuvendi i Shqipërisë miratoi në muajin maj 2021 "Ligjin për të Huajt". Qëllimi i ligjit për të huajt është të afrojë praktikën shqiptare me standardet evropiane të hyrjes dhe qëndrimit në vend të shtetasve të huaj. Krahas përmirësimit të sistemit të vizave në përgjithësi, ligji rregullon futjen dhe qëndrimin në Shqipëri për qëllime punësimi të shtetasve të huaj të të gjitha llojeve dhe fushave, përfshirë imigrantët e përkohshëm ekonomikë. Kështu, ai rregullon ardhjen në Shqipëri të personave të huaj që duan të investojnë; të punonjësve të kompanive të huaja që veprojnë në Shqipëri, të ekspertëve të pavarur dixhitalë që mund të punojnë nga çdo vend i botës, etj.

Ligji lehtëson ndjeshëm mënyrën e marrjes së lejes së punës dhe lejes së qëndrimit për shtetasit e huaj që kanë një ofertë pune në Shqipëri, për të gjitha llojet e punësimit. Duke qenë se ekonomia e Shqipërisë ofron pak mundësi për punë të kualifikuara, përfituesit kryesorë nga ky ligj mund të jenë punëtorët e pakualifikuar. Ky parashikim përforcohet nga nevoja e shprehur publikisht nga kompani fasone dhe të ndërtimit për të marrë punonjës të pakualifikuar pasi nuk gjejnë shqiptarë që mund të bëjnë punët që ata kanë. Në fakt, një sërë kompanish shqiptarë kanë punësuar, tashmë, punëtorë nga Bangladeshi dhe disa vende të tjera të pazhvilluara.

Imigrimi ekonomik është parë më pesimizëm nga një pjesë e opinionit publik, analistë publik dhe politikanëve. Në arsyetimin e kthimit të ligjit në Kuvend, Presidenti Meta përmbledhi këto shqetësime duke argumentuar se Shqipëria rrezikon të përballet me shumë kërkesa për punësim nga shtetas të vendeve të varfra dhe nuk ka kapacitete të mjaftueshme për të pritur fluks njerëzish.

Imigracioni ka qenë përgjithësisht faktor zhvillimi në botë. Ky fakt është konfirmuar në shumë vende dhe kohë të ndryshme. Por ndërsa ka një konsensusi për këtë pikë për sa i përket emigracionit të krahut të kualifikuar të punës, ka një debat të madh në botë në lidhje me imigrimin e punonjësve të pakualifikuar.

PROPOZIMI DHE ARGUMENTET PRO DHE KUNDËR

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<p><b>Shqipëria duhet të jetë e hapur të pranojë fuqi të huaj punëtore (imigrantë).</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në shumë sektorë nuk ka shqiptarë të gatshëm për t'u punësuar dhe, rrjedhimisht, do të punësohen imigrantë për të plotësuar vendet e mbetura bosh. Për shumë kompani, sidomos në ndërtim dhe fasoneri, kjo gjë do të jetë shpëtim nga falimentimi, pasi këto kompani ndeshen me rritje të kostove dhe me mungesë kapacitetesh prodhuese për shkak të mungesës së fuqisë punëtore. Një falimentim i tillë do të shtonte më tej papunësinë mes shqiptarëve, pasi të gjithë punonjësit e kompanive, përfshirë edhe ata në pozicione të mira ku kërkohen aftësi të larta, do të humbisnin vendin e punës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ardhja e të huajve do të rrisë papunësinë mes popullsisë shqiptare. Imigrantët do të shtojnë papunësinë, pasi çdo vend pune i zënë prej tyre është një vend pune që i merret një punëtori vendas. Në këtë mënyrë, imigrimi i të huajve do të nxisë edhe më shumë emigrimin e shqiptarëve.</li> <li>Ardhja e imigrantëve të pakualifikuar do të ulë rrogat e punëtorëve vendas të pakualifikuar. Punëdhënësit, duke pasur kërkesë më të ulët për rroga nga imigrantët, do të refuzojnë punësimin e punonjësve të pakualifikuar vendas që duan rroga pak më të larta.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Punëtorët e pakualifikuar që kanë humbur vendin e punës për shkak të imigrantëve, do të kenë tanimë motivimin që të arsimohen e të ndjekin trajnime për të rritur nivelin e aftësive, dhe për të konkurruar për vende pune ku rroga është më e lartë dhe konkurrenca nga punëtorët e huaj është jonekzistente. Kështu, punëtorët e pakualifikuar vendas do të kenë më shumë mundësi për të investuar në përfitim të zanateve dhe profesioneve që kërkojnë kualifikime më të mira.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krahu i lirë i punës do të ulë dhe mbajë të ulur produktivitetin e ekonomisë së vendit, duke mbajtur të pazhvilluar industrinë dhe duke mos bërë të mundur përmirësimin e strukturës ekonomike. Që një vend të zhvillohet, duhet të rrisë produktivitetin dhe të prodhojë më shumë me të njëjtën fuqi punëtore dhe lëndë të parë. Në vend që të rrisin investimet në teknologji të avancuara dhe aktivitete më komplekse, për t'i mbijetuar konkurrencës dhe për të ruajtur fitimet, bizneset mbeten në sektorë ku puna manuale është një faktor i rëndësishëm, pasi kostoja e punës mbetet e ulët.</li> </ul>

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në vendet e zhvilluara punëtorët e pakualifikuar luajnë një rol të madh ekonomik. Ata çlirojnë fuqinë punëtore vendase nga puna me produktivitet të ulët për t'u fokusuar në punën me produktivitet të lartë. Rasti tipik është ai i vendeve perëndimore të BE-së. Ardhja e fuqisë punëtore të pakualifikuar nga vendet lindore që iu bashkuan BE-së pas rënies së komunizmit bëri të mundur që punëtorët vendas, si britanikët, francezët, danezët, gjermanët, etj., të specializoheshin në punë më të kualifikuara, duke ua lënë punët që kërkonin krahë të lirë pune imigrantëve. Kjo rriti produktivitetin ekonomik të vendit me një ritëm më të shpejtë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxitet largimi i fuqisë punëtore të kualifikuar. Ruajtja e ekonomisë së pazhvilluar me fuqi punëtore të lirë nxit më tej emigrimin e punëtorëve të kualifikuar. Nëse nuk zhvillojmë teknologjinë e informacionit dhe komunikimit si dhe sektorë me vlerë të shtuar, profesionistët do të largohen. Në fakt, emigracioni shqiptar kohët e fundit është më i përhapur mes profesionistëve (mjekë, inxhinierë, ekspertë IT etj.). Ekonomia shqiptare nuk u ofron atyre mundësi konkurruese dhe shpërblime.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Imigrantët e huaj që vijnë nga kultura dhe shoqëri të ndryshme do të pasurojnë kulturën dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi, përmes jelljes së ideve të reja.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Imigrimi i të huajve nga vendet e pazhvilluara dëmton harmoninë sociale. Ka një shqetësim të madh se ardhja e të huajve nga kultura dhe shoqëri të ndryshme do të krijojë probleme sociale në vend.</li> </ul>

## NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE MJEDISI

### KONTEKSTI

Mjedisi ka qenë një pjesë e vazhdueshme e debatit politik në dy dekadat e fundit, veçanërisht për sa i përket shërbimeve mjedisore, si çështjet që lidhen me menaxhimin e integruar të mbetjeve, trajtimin e ujërave të zeza, etj. Në vitet e fundit, debati është zhvendosur edhe në çështje të tjera, si ndryshimet klimatike, sektori i transportit të qëndrueshëm, prerjet e paligjshme, gjuetia, mirëqenia e kafshëve etj. Edhe pse Shqipëria nuk ka të miratuar një strategji për mjedisin, ajo ka miratuar së fundmi (korrik 2019) Dokumentin Strategjik së bashku me

Planin Kombëtar për Zbutjen e Gazrave me Efekt Serrë (NMP) dhe Planin Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP). Kuvendi i Shqipërisë nënshkroi Marrëveshjen e Parisit më 14 korrik 2016, duke hyrë në fazën e re të politikave ndërkombëtare të klimës. Në këto politika është përfshirë sektori i transportit, që është edhe konsumatori më i madh i energjisë (39.15% në vitin 2014). Numri i automjeteve në rrugë po rritet vazhdimisht, ndërkohë që transporti publik ka humbur më shumë se 50% të pasagjerëve gjatë dy dekadave të fundit. Rritja e ndjeshme e numrit të mjeteve rrugore u shoqërua me rritje të aktivitetit të transportit dhe rritje të dukshme të konsumit të karburanteve, kryesisht naftë dhe benzinë.

## Ulja e emetimeve në transport

Çfarë mund të bëhet? Një mënyrë është të nxitet reduktimi i emetimeve përmes vendosjes së taksave ose stimujve të tjerë ekonomikë. Për transportin, një nga masat për reduktimin e emetimeve të gazrave serë është detyrimi që të gjitha makinat dhe kamionët e rinj që hyjnë në territorin shqiptar të jenë mjete me emetim zero ose të ulët karboni (të tilla si automjetet elektrike apo ato hibride). Megjithatë, bazuar në statistikat e vitit 2020, vetëm 0.5% e makinave të regjistruara në Shqipëri

përbushnin aktualisht këtë standard (plotësisht elektrike ose hibride) dhe këto makina janë të shtrenjta. Ndërkohë i vetmi sektor që ka përparuar në këtë drejtim është shërbimi i taksive në Tiranë, ndërsa për kamionët ky standard është shumë larg. Për momentin, të vetmet masa të marra janë si vijon: (i) Nuk ka taksë regjistrimi për makinat elektrike; (ii) shteti rimbursion 7,500 lekë për PHEV. Ndryshimi në këtë lloj transporti do të kërkojë investime që nuk janë të lehta për t'u mbuluar nga buxheti i shtetit dhe nga vetë konsumatorët.

## PROPOZIMI DHE ARGUMENTET PRO DHE KUNDËR

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
<b>Shqipëria duhet të bëjë të detyrueshëm emetimin zero të karbonit për makinat, kamionët, autobusët deri në 2035.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Në këtë mënyrë do të ndihmojë Shqipërinë të shkojë drejt transformimit të nevojshëm energjetik, për të shmangur katastrofën klimatike,</li> <li>■ Dekarbonizimi i sektorit të transportit është një nga çështjet kryesore që duhet trajtuar me qëllim përmbushjen e objektivave të vendosur.</li> <li>■ Ky transformim do të reduktojë ndotësit e ajrit (NOx, SOx. etj.)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Ndryshimi në një afat relativisht të shkurtër kohor do të sjellë kosto shumë të larta financiare dhe kosto të tjera që ekonomia nuk mund t'i përballojë.</li> <li>■ Nuk është ngritur ende infrastruktura për karikimin e automjeteve elektrike.</li> <li>■ Shqipëria nuk është një eksportues neto i energjisë elektrike dhe si e tillë rritja e kërkesës do të kërkojë më shumë import të energjisë elektrike.</li> </ul>
<b>Shqipëria duhet të ndalojë importin e makinave të përdorura më shumë se 5 vjet.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Me këtë hap do të zvogëlohen emetimet (shkarkimet) për numër makinash dhe do të përmirësohet cilësia e ajrit, veçanërisht në qytetet e mëdha.</li> <li>■ Makinat e reja do të sjellin përmirësimin e efikasitetit të karburantit dhe rrjedhimisht më pak konsum të karburantit</li> <li>■ Kjo është në përputhje me politikat e BE-së në sektorin e transportit (standardet Euro)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Me nivelin e të ardhurave që kanë aktualisht, qytetarët e thjeshtë nuk mund t'i përballojnë dot kostot e blerjes së një automjeti të ri.</li> <li>■ Në vend ka një sektor mjaft të madh të shitësve të makinave të përdorura dhe pjesëve të këmbimit të përdorura, që do të vuajnë në këtë tranzicion.</li> <li>■ Për momentin nuk ka stimuj të drejtpërdrejtë nga të cilët klientët përfitojnë, në rast se duan të kalojnë në përdorimin e makinave të reja</li> </ul>

PROPOZIMET	ARGUMENTET PRO	ARGUMENTET KUNDËR
Jam dakord që në qytetet e mëdha të krijohen zona me emetim të ulët (p.sh. në qendër të qytetit të lejohet qarkullimi vetëm i mjeteve elektrike)	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Qendrat e mëdha urbane vuajnë nga ndotja dhe bllokimi i trafikut që vjen si rezultat i trafikut të makinave</li> <li>■ Zonat me emetim të ulët do të nxisin përdorimin e alternativave miqësore me mjedisin (transport publik, biçikleta etj.)</li> <li>■ Përmirësohet cilësia e jetës së njerëzve që jetojnë në qendër të qyteteve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Njerëzit do të kundërshtojnë pagesën e një takse tjetër që lidhet me qarkullimin</li> <li>■ Reduktimi i trafikut në qendër do ta kalojë problemin në pjesë të tjera të qytetit.</li> <li>■ Transporti publik dhe alternativat e tjera nuk janë ende në nivelin e dëshiruar të cilësisë për të justifikuar këtë propozim.</li> </ul>

## FJALORTH

**GAZRA SERË:** gazra që bllokojnë nxehtësinë në atmosferën e tokës, përfshirë këtu edhe di oksidin e karbonit (i cili krijohet nga djegia e lëndëve djegëse fosile si nafta dhe gazi), metanin, oksidin e azotit dhe gazrat e fluoruar

**MARRËVESHJA E PARISIT:** marrëveshje e arritur në fund të vitit 2015 nga pothuajse gjysma e shteteve të botës ku përcaktohet kuadri për trajtimin e ndryshimeve klimatike në të gjithë botën.

**PHEV:** automjete hibride elektrike, bateria e të cilave mund të karikohet duke futur një kabëll karikimi në një prizë me energji elektrike.

**AUTOMJETE ME EMETIM TË ULËT OSE ZERO:** automjete që emetojnë pak ose aspak gazra dhe tymra (shpesh automjetet elektrike).

# Mirënjohje

## **Rreth organizatorëve**

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në fokus të veprimtarisë së vet ka qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efikase përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.

Ky aktivitet zhvillohet për herë të parë, nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në konsultim me Qendrën për Demokraci Deliberative pranë Universitetit Stanford (ShBA), në kuadër të “Mbështetje për Parlamentin dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri” (PACEP), projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatuar nga NDI - Instituti Demokratik Amerikan.

## **Partnerët mediatikë të këtij aktiviteti**

A2CNN është një kanal informativ në një partneritet ekskluziv me CNN, me seli dhe qendër kryesore të prodhimit në Tiranë.

Citizens Channel është një media e re online që aspiron të kontribuojë në lirinë e shprehjes në Shqipëri.

## **Bordi Këshillimor i “Shqipëria n’Kuvendim”**

Edlira Gjoni

Neritan Sejamini

Blendi Ceka

Elona Dhembo

Marsela Dauti

Gjergj Erebara

Një falënderim për të gjithë ata që përgatitën këto materiale informuese:  
Edlira Gjoni, Neritan Sejamini, Rezart Kapedani, Endrit Shabani.

Editor: Gjergji Vurmo, IDM, Besjana Kuci, IDM